2022

# RAPORT

## PËR SITUATËN E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE PËR VITIN 2021



Ky raport u bë i mundur me mbështetjen financiare të ofruar nga "Bashki të Forta" një projekt i Agjencisë Zviceriane për zhvillim dhe Bashkëpunim (SCD) nën supervizimin e Znj. Valbona Karakaçi, Këshilltare Strategjike e BtF dhe Znj. Arbëresha Mushani Oficere Programi e BtF.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të "Bashki të Forta" dhe të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SCD).

Tiranë, 2022

**PËRGATITI:**

**BESMIRA PETRITI**

**KONTRIBUES: EDLIRA ÇEPANI, VASILIKA LASKA**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

BASHKI të FORTA

HELVETAS ALBANIA

BARAZI në VENDIMMARRJE

## SHKURTESAT

**AGK** – ALEANCA E GRAVE KËSHILLTARE (NË NIVEL TË KËSHILLAVE BASHKIAKË)
**BGJ** - BARAZIA GJINORE
**CEDAË** - KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE
**DHBGJ** - DHUNË ME BAZË GJINORE
**DHF** – DHUNË NË FAMILJE
**KVDHF** – KOORDINATORE/KOORDINATOR VENDOR KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE
**MSHMS** - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
**MKR** - MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE
**NBGJ** - NËPUNËSE/NËPUNËS I BARAZISË GJINORE
**NJA** - NJËSIVE ADMINISTRATIVE
**OJF/OSHC** - ORGANIZATË JO-FITIMPRURËSE/ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE
**SPZ** - SPECIALISTI I POLICISË SË ZONËS
**UM** - URDHËR MBROJTJEJE
**UMM** – URDHËR I MENJËHERSHËM MBROJTJEJE
**UMPMM** – URDHËR PËR MASA PARAPRAKE TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME
**VKB** - VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK
**VKM** - VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**ZVAP** – ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

## PASQYRA E LËNDËS


Hyrja dhe Qëllim

METODOLOGJIA

KAPITULLI 1
SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE GJATË VITIT 2021
Krahasim 2020-2021
Shërbimet e ofruara nga bashkitë gjatë vitit 2021
Këndvështrimi i organizatave për situatën e dhunës

KAPITULLI 2
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL
2.1. Policia
2.2. Qendrat Shëndetësore
2.3. Njësitë e Qeverisjes Vendore
2.4. Prokuroria
2.5. Gjykata

KAPITULLI 3
MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT
3.1. Funksionimi i Mekanizmit
3.2. Koordinatori i Dhunës
Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse
Situata buxhetore e bashkive

KAPITULLI 4
Raste suksesi dhe praktika të mira për vitin 2021 në shërbimet dhe në adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje
SUGJERIME DHE REKOMANDIME

# Hyrje

Pavarësisht se në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të madh në lidhje me përmirësimin e politikave kombëtare për promovimin e barazisë gjinore apo luftës ndaj dhunës në familje dhuna ndaj grave vazhdon të mbetet një shqetësim i përditshëm. Harmonizimi i legjislacionit me standartet ndërkombëtare ka sjellë një frymë të re bashkëpunimi për përmirësimin e cilësisë së jetës së viktimave të dhunës në vendin tonë. Shoqëritë më të zhvilluara sot në botë, duket se çelësin e suksesit e kanë edhe tek shanset e hapësirat që ofrojnë e krijojnë për gratë, gjysmën më të mirë të popullsisë, duke vënë në efiçencë talentin, energjinë dhe përkushtimin e tyre. Sa më i vogël hendeku mes burrit dhe gruas aq më e mirë është performanca e shoqërisë, si nga këndvështrimi social ashtu edhe ekonomik. Dhuna në familje në shoqërinë shqiptare përbën një nga krimet më të raportuara.

Shërbimët e institucioneve tona duhet të ofrojnë një plan sigurie për të mbijetuarit/at e dhunës në familje, fillimisht për tejkalimin e emergjencës dhe më pas trajtimin psikologjik, social dhe ekonomik, si dhe ofrimin e mundësive të punësimit e rehabilitimit të të mbijetuarve të dhunës.

Ky raport është hartuar nga Rrjeti "Barazi në Vendimmarrje" në bashkëpunim me "Gruaja në Integrim", me mbështetjen e projektit Bashki të Forta dhe ka si qëllim identifikimin e problematikave dhe sfidave me të cilat përballen bashkitë e vendit në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Raportimi i rasteve të dhunës është një nga elementet bazë të vënies në lëvizje të mekanizmit institucional përsa i takon ofrimit të shërbimeve. Raporti pasqyron situatën faktikë të raportimit të dhunës, mënyrën sesi bashkitë apo njësitë e qeverisjes vendore në tërësi kanë menaxhuar rastet e dhunës si dhe sfidat dhe detyrat që iu ngarkohen mekanizmave të ngritur në lidhje me adresimin dhe zgjidhjen e tyre.

Duke konsideruar situatën e krizës ekonomike e sociale si dhe atë post COVID-19, sfidat mbetën ende të mëdha ashtu sikundër edhe përkushtimi institucional duhet të rritet duke trajtuar me dinjitet dhe përkushtim të mbijetuarit/at e dhunës si dhe duke mundësuar ofrimin e shërbimeve me kapacitete të plota.

Shqetësuese mbetet mbështetja e kufizuar financiare e MKR-së nga buxheti i shtetit dhe zëvendësimi i shpeshtë të burimeve njerëzore të MKR-së. Alokimi i fondeve të mjaftueshme dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve të qendrave të trajtimit të të mbijetuarve të DHF është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të grave të dhunuara, ofrimi i shërbimeve emergjente si dhe atyre afatgjata të trajtuara në këtë raport mbeten ndër sfidat më thelbësore të këtij studimi.

Proporcionaliteti i ofrimit të shërbimeve vendore, në raport me situatën e të mbijetuarve të dhunës është një nga elementët më të brishtë të vlerësimit të profesionistëve, i cili duhet të marrë vëmendjen dhe vlerësimin e duhur të institucioneve.

# METODOLOGJIA

Hartimi i këtij raporti studimor ka kërkuar një angazhim serioz dhe të përkushtuar të ekspertëve dhe institucioneve vendore duke mundësuar një pasqyrim të qartë midis nevojave të paraqitur për menaxhimin e rasteve të dhunës, mundësitë që bashkitë tona ofrojnë si dhe sfidat që hasen në përditshmëri.

Për hartimin e këtij raporti jemi bazuar në dy instrumenta kryesorë:
1) Të dhënat bazë të prodhuara nga administratat e bashkive të përfshira në këtë raport dhe
2) Të dhënat bazë të përfituara nga organizatat e shoqërisë civile të cilat operojnë në bashkitë e vendit.

Raportimi i strukturave përgjegjëse në Bashki për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore realizohet nga Drejtoria e shërbimeve Sociale/Sektori i përfshirjes Sociale, Koordinatori vendor i dhunës në familje etj. Ky raportim përgatitet për interes të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në Këshillin Bashkiak dhe të Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare Bashkiake të Bashkisë me qëllim vlerësimin e situatës së dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë vitit 2021, nevojat e identifikuara dhe marrjen e masave në nivel vendimmarës për adresimin e tyre.

Gjithashtu, nga ana e organizatave të shoqërisë civile përgatitet një raportim në kuadër të Raportit Periodik për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për interes të Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale në Këshillin Bashkiak të Bashkisë dhe Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare Bashkiake. Pyetësori i siguruar nga organizatat e shoqërisë civile synon të mbledhë informacion në dy fusha kryesore: informacion mbi situatën e dhunës dhe mbi situatën e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtij pyetësori janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllimin e këtij raporti.

# SFIDAT E EVIDENTUARA DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME:

**Rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kanë pësuar një rritje nga viti 2020-2021 me 260 raste.** Bashkia Krujë, Maliq, Elbasan, Fier, Shkodër, Durrës dhe Kolonjë raportojnë rritjen më të lartë të rasteve të dhunës. Mungesa e një fondi të posaçëm për menaxhimin e rasteve, e strehimit afatgjatë dhe në tërësi programit social janë ndër nevojat më emergjente të bashkive.

**Shërbimi më pak i ofruar nga ana e bashkive për të mbijetuarit/at e dhunës ka qenë "strehimi afatgjatë",** kjo për shkak të mungesës së fondeve për përfshirje në politikat e strehimit. Evidentohet se nevojitet rritja e numrit të shërbimeve në mbështetje të grave e vajzave, duke përfshirë edhe strehëzat afatgjata dhe strehëzat emergjente, shmangien e kontaktit me dhunuesin, përfshirjen në programet e bonuseve të qerase si dhe rritjen e buxhetit për punësim dhe reintegrim. Vetëm Bashkia e Tiranës ka raportuar për zbatimin e një programi subvencionimi të qerasë ku janë miratuar 314 individë ndër të cilët 207 janë gra. Për programin subvencionimi i interesave të kredisë totalisht 806 janë përfitues ndër të cilët 369 janë gra.

**Vetëm 14 Bashki kanë raportuar se numri i rasteve të dhunës ka pësuar ulje.** Të gjitha bashkitë e tjera kanë pësuar rritje të rasteve të dhunës. Sfidë mbetet rritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të stafeve të Shërbimit Social për rezultate të arritura në luftën kundër dhunës. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe mjeteve logjistike për punonjësit e shërbimit social për të aksesuar edhe në zonat më të thella të bashkisë ku punojnë, për të identifikuar rastet e dhunës, monitoruar dhe ofruar shërbime në një kohë sa më të shpejtë dhe në mënyrë eficente, mbetet një sfidë tjetër e paadresuar.

**Paraqitet një mungesë e konsultimit të buxhetit,** dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për rastet e dhunës. Vetëm në Bashkinë Shkodër janë kryer dëgjesa publike në lidhje me nevojat e komunitetit sa i takon edhe problemeve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

**Bashkitë raportojnë për paqëndrueshmërinë e stafit në shërbimin social duke sjellë pasoja në ofrimin e shërbimeve.** Kërkohet marrja e masave për një plan të mirëmenduar të rekrutimit të ekspertëve të cilët do të ofrojnë shërbimet sociale si një mënyrë e rritjes së profesionalizmit dhe eficencës në ofrimin e shërbimeve.

**Bashkitë apelojnë për mungesën e stafeve të trajnuara në pozicionin psikolog dhe jurist** mbi protokollet e veçanta të kujdesit social e shëndetësor, konfidencial dhe të përditësuara me protokollet e fundit.

**Formimi profesional në disa bashki është rast i mirë suksesi në Bashki si: Berati, Korça, Pogradeci, etj, por evidentohet mungesë e këtij shërbimi në shumicën e bashkive.** Kërkohet parashikimi në buxhet i një zëri për reintegrimin e të mbijetuarve të dhunës duke ju mundësuar ofrimin e formimit profesional.

**Rekomandohet ndërmarrja e fushatave sensibilizuese për informimin e komunitetit lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të mbijetuarës së dhunës dhe të drejtat e saj.** Kjo është një praktikë e mirë e ndjekur nga Bashkia Gjirokastër, e cila ka ofruar informim për publikun.

**Përmbushja e detyrimit të njësive të vetëqeverisjes vendore për të emëruar punonjës me kohë të plotë në pozicionin e Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje, juristit edhe psikologut.** Rekrutimi i koordinatorit me kohë të plotë në 11 Bashki (9 me kohë të pjesshme, 2 Bashki nuk kanë, Durrës dhe Shkodër) në të cilat koordinatori punon me kohë të pjësshme pasi mban dhe pozicionin e përgjegjësit të sektorit është një emergjencë për menaxhimin e rasteve të dhunës. Bashkia Shkodër ka rritje të rasteve të dhunës por vijon të jetë në procës rekrutimi.

**Organizimi në mënyrë sistematike i trajnime të përbashkëta të punonjësve të bashkive me punonjës të institucioneve të ndryshme që merren me dhunën në familje (policia, bashkia, gjykata, prokuroria, zyra e përmbarimit, shkollat, qendra shëndetësore, media, OJF-të etj.) të fokusuara tek ndryshimet ligjore, strukturat e reja etj.**

**Mungesa e mjeteve të transportit për monitorimin fizik të të mbijetuarve të dhunës të pajisura me urdhër mbrojtje është një sfidë tjetër,** e cila duhet domosdoshmërisht të adresohet për një monitorim sa më eficent. 47% e Bashkive apelojnë për mundësimin e transportit për të ofruar një transport të sigurt për viktimat por gjithashtu edhe punonjësit e shërbimit social për monitorim. Nga ana tjetër vlen për t'u përmendur praktikat e mira të Bashkisë Rroskovec, Berat, Elbasan etj të cilës kanë kryer në mënyrë të vazhdueshme vizita për të monitoruar respektimin e UM.

**Përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike e të mbijetuarve të pajisur me UM në Bashkinë e Korçës dhe Pukës** është një praktikë e mirë e cila do të vlente dhe ndihmonte edhe të mbijetuarit/at e dhunës në bashkitë e tjera.

**Bashkia Përmet dhe Bashkia Dropull raportojnë se për vitin 2021 nuk kanë patur asnjë rast me UM,** ndërkohë që Bashkia Skrapar është e vetmja Bashki që raporton moskryerjen e monitorimit të urdhrave të mbrojtjes.

**49 % e Bashkive apelojnë për ngritjen e Strehëzave të emergjencës si domosdoshmëri për ofrimin e shërbimeve në raste emergjente.**

# KAPITULLI I.

SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE GJATË VITIT 2021.

I.I Krahasim i situatës së dhunës për vitin 2020-2021

Si rezultat i monitorimeve dhe raportimeve në 61 Bashkitë e vendit, në raport me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje rezulton se në mjaft bashki janë bërë hapa të rëndësishme për frenimin e rasteve të dhunës nëpërmjet mekanizmave dhe shërbimeve që bashkitë ofrojnë. Megjithë përpjekjen e vazhdueshme, gjendemi në një rritje të rasteve të dhunës në rang kombëtar, kjo për arsye nga më të ndryshmet. Konventa CEDAW , *"Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje"*, e ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 DHF dhe DHBGJ i përkufizon si më poshtë:

***"Dhunë në familje"*** *nënkuptohen të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;*

***"Dhunë me bazë gjinore"*** *nënkupton dhunën që drejtohet kundër një personi për shkak të gjinisë, kjo dhunë prek gratë në mënyrë disproporcionale;*

*Koncepti i Dhunës në familje përkufizohet edhe nga legjislacioni shqiptar si forma e çdo veprimi apo mosveprimi të një personi ndaj një personi tjetër, që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare, e që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.*

Nga ana tjetër parimet dhe kërkesat e Konventës së Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje) sigurojnë një kornizë për hartimin dhe zbatimin e masave për të siguruar barazinë midis grave dhe burrave dhe për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, e cila aplikohet në çdo kohë, sidomos ka marrë edhe më shumë peshë pas pandemisë COVID-19. Në kushtet e post pandemisë së COVID-19, krizës ekonomike dhe sociale si dhe shumë faktorë të tjerë të cilët do të jenë objekt i këtij studimi.




***Grafiku 1:*** *Rastet e dhunës në familje 2020-2021*

Nga të dhënat, rezulton se për vitin 2021, paraqitet një rritje prej 260 rastesh të reja në të gjithë vendin. Bashkitë si Belshi, Bulqiza, Elbasani, Fieri, Gjirokastër, Has, Himarë, Kavajë, Konispol, Krujë, Kurbin, Librazhd, Maliq, Pukë, Shkodër Durrës etj, kanë pësuar një rritje të rasteve ndërkohë bashki të tjera si Sarandë, Dropull, Malësi e Madhe, Shijak, Korcë, Peqin, Këlcyrë, Delvinë, Përmet, Ura Vajgurore, Tiranë dhe Berat kanë pësuar ulje të rasteve të dhunës. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rasteve të dhunës në familje janë nga më të ndryshmit, duke filluar nga ata socialë e ekonomikë.

Rritja e rasteve të dhunës ka ndikim të drejtpërdrejtë në shkatërrimin e familjes dhe rrjedhimisht në pengimin e zhvillimit të një shoqërie të shëndoshë. Duhet të nënvizojmë se me ndryshimet ligjore të ndodhura së fundmi, dhuna që ndodh brenda katër mureve të një familjeje nuk shihet më si një çështje personale midis dy njerëzve por si një çështje e cila vendos në lëvizje një tërësi institucionesh për mbrojtjen e të drejtave të të mbijetuarës, dinjitetit dhe shëndetit të saj. Reintegrimi i të mbijetuarve të dhunës dhe ofrimi i shërbimeve nga ana e mekanizmave përgjegjës për mbrojtjen e tyre, janë ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballen edhe organet e vetëqeverisjes vendore.

Bashkia Dropull është e vetmja bashki e cila raporton 0 raste dhune për vitin 2021. Nga ana tjetër bashki si Konispoli, Skrapari dhe Memaliaj nga 0-1 raste në vitin 2020, për vitin 2021 raportojnë 10 fishin e rasteve. Rritjen me të madhe e ka pësuar Bashkia e Krujës nga 24 (2020) - 70 (2021), e dhënë e cila është mjaft shqetësuese përsa i takon masave dhe veprimeve që duhet të ndërmerren nga ana e organeve përgjegjëse. Në mënyrë grafike më poshtë është paraqitur edhe situata e raportimit të rasteve të dhunës për çdo bashki për vitin 2020-2021.




***Grafiku 2:*** *Rastet e raportuara të dhunës për vitin 2020-2021*

Sikundër e përmendëm në fillim të këtij raporti, një këndvështrim shumë të rëndësishëm dhe të hollësishëm kanë paraqitur edhe organizata të ndryshme të cilat operojnë në shumicën e bashkive të vendit. Sipas tyre për vitin 2021, këndvështrimi i shoqatave/organizatave të pyetura në lidhje me situatën e dhunës në familje dhe dhunën me bazë gjinore paraqitet si më poshtë:




***Grafiku 3:*** *Rastet e dhunës në familje në këndvështrimin e organizatave 2020-2021*

# I.2. SHËRBIMET E OFRUARA NGA BASHKITË NË KUADËR TË DHUNËS NË FAMIJE 2021.




Në kuadër të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për të mbijetuarit/at e dhunës në familje, që ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore në përmbushje të Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE" (i ndryshuar), përcaktohet qartësisht roli i njësive të vetëqeverisjes vendore në marrjen e masave ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Konkretisht Bashkitë janë pyetur për shërbimet e ofruara në rastet e evidentimit të dhunës në familje dhe shërbimet e ofruara rezultojnë si më poshtë:

## SHËRBIME TË EMERGJENCËS (STREHËZA EMERGJENCE)

**37 Bashki ofrojnë strëhëz emergjence** për të mbijetuarit/at e dhunës. Referuar Udhëzimt nr. 744, datë 15.11.2019 "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)" janë miratuar edhe standardet minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente). Detyrimet që i ngarkohen shtetit tonë nga Konventat e ratifikuara konkretisht në nenin 23 të Konventës së Stambollit përcaktohet se:

> *Shtetet palë duhet të marrin masat e nevojshme, përfshirë dhe ato legjislative, për të mundësuar ngritjen e strehëzave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme dhe në një numër të mjaftueshëm, për të ofruar akomodim të sigurtë dhe për të arritur në mënyrë proaktive te të mbijetuarit/at, veçanërisht për gratë dhe fëmijët e tyre. Strehëzat duhet të sigurojnë akomodim të menjëhershëm, të sigurtë dhe mundësisht gjatë 24 orëve për të mbijetuarit/at, në mënyrë të veçantë për gratë dhe fëmijët, kur nuk janë më të sigurtë në shtëpitë e tyre. Vetëm strehimet e përkohshme apo strehëzat e përgjithshme, si p.sh., shtëpitë për të pastrehët,* ***nuk janë të mjaftueshme.***

Bashkia, si ofruese e këtij shërbimi për të mbijetuarit/at e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, miraton një procedurë për ruajtjen e fshehtësisë së vendit të strehëzës emergjente, me qëllim sigurimin e jetës së të mbijetuarve dhe stafit të strehëzës. Po kështu, ajo merr të gjitha masat për planifikimin e burimeve të duhura financiare e njerëzore për vazhdimësinë e shërbimit të strehimit emergjent, si dhe kompletimin e tij me më shumë burime në dispozicion, qoftë përmes sigurimit të bashkëpunimit të qëndrueshëm me aktorët e tjerë në nivel vendor dhe qendror, qoftë edhe nëpërmjet përfshirjes së këtij grupi shpenzimesh, si pjesë e planeve buxhetore të bashkisë.

Nga të dhënat rezulton se **Bashkia e Fierit,** si një nga bashkitë me numrin më të lartë të raportuar të rasteve të dhunës, nuk e ka ofruar këtë shërbim për vitin 2021. **Bashkia Tiranë** po ashtu raporton se nuk e ofron shërbimin e strehëzës së emergjencës pavarësisht numrit të lartë të rasteve të dhunës që paraqet. Nga ana tjetër në **Bashkinë e Shkodrës** gjatë vitit 2021 është ngritur strehëza e emergjencës.

Duke qenë se mundësimi i strehimit emergjent për të mbijetuarit/at është një nga problematikat e bashkive, në Bashkitë e Kamzës, Rroskovecit, Kucovës, Pukës, Selenicës, Himarës, Vlorës, Shijakut, Peqinit, Elbasanit, Kukësit, Kavajës, Lushnjës, Tropjës e Hasit **strehimi emergjent është ofruar nga organizatat e shoqërisë civile** të cilat në shumicën e rasteve kanë ndihmuar të mbijetuarit/at e dhunës edhe me bonuse strehimi duke iu ofruar një strehim më afatgjatë se ai emergjent. Paketat higjeno sanitare, veshmbathje, mbështetje me pako ushqimore, kurse profesionale për zhvillimin personal, organizimi i takimeve sensibilizuese për komunitetin, etj kanë qenë ndër shërbimet kryesore e ofruara nga ana e organizatave të shoqërisë civile në bashkitë tona gjatë vitit 2021. Bashkia Durrës ofron të gjitha shërbimet përfshirë edhe strehimin emergjent.

## TRANSPORT DREJT NJË MJEDISI TË SIGURTË

**33** **Bashki ofrojnë transport drejt një mjedisi të sigurtë për të mbijetuarit/at e dhunës.** Ky është një shërbim i cili duhet të ofrohet nga njësitë e qeverisjes vendore përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet e mbijetuara ku i garantohet dhe mbrojtja sipas ligjit. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, si dhe **transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara.** Për këtë vendim transferimi duhet të merret edhe mendimi i së mbijetuarës së dhunës. Me qëllim sigurinë e të mbijetuarës së dhunës në familje, i ofrohet transporti falas dhe i sigurt për në strehëz ose në institucione të tjera, nga Sektori i Shërbimeve Sociale në bashki, koordinatorja vendore kundër dhunës në familje në bashkëpunim me policinë dhe anëtarët e tjerë të mekanizmit të referimit.

Në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi, nga monitorimi rezulton se **Bashkia Elbasan** (në 2020 ka raportuar 124 raste dhune- 2021 raportuar 144 raste dhune), **Bashkia Krujë** (2020-24 raste dhune- 2021-70 raste dhune) **Bashkia Klos** (2020 raportuar 7 raste dhune-2021 raportuar 16 raste dhune) si dhe Bashkia Tiranë, nuk e ofrojnë shërbimin e "transportit drejt një strehimi të sigurtë".

Nga ana tjetër ky shërbim nuk ofrohet as nga bashkitë Prrenjas, Vau i Dejës, Rrogozhinë, Berat, Pukë, Patos, Fier, Selenicë, Sarandë, Vlorë, Malësi e Madhe, Pogradec, Shijak, Korçë, Maliq, Konispol, Kurbin, Peqin, Mirditë, Lezhë, Bulqizë, Kavajë, Lushnje, Delvinë, Shkodër, Librazhd, Memaliaj, Mallakastër, Tropojë, Tepelenë dhe Has. Nga raportimet e bashkive rezulton se disa bashki **nuk kanë në dispozicion mjete transporti dhe logjistikën e nevojshme për të ofruar këtë shërbim.** Mundësimi i mjeteve nga ana e strukturave përgjegjëse të bashkisë do të mundësonte ofrimin e shërbimit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në të gjithë hapësirën që bashkia mbulon.

## KUJDES SHËNDETËSOR

**45** Bashki ofrojnë kujdesin shëndetësor për rastet e dhunës ku referuar legjislacionit në fuqi në rast të dhunës në familje, e mbijetuara mund t'i drejtohet me anë të një kërkese njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore për të marrë masat e nevojshme. Nga monitorimi rezulton se në **Bashkinë e Sarandës** është ofruar dhe asistencë dhe mbështetje psikologjike në bashkëpunim me OJF në **Bashkinë e Belshit** është ofruar asistencë psikologjike, në **Bashkinë e Kurbinit,** në **Bashkinë e Cërrikut, Bashkinë e Mirditës, Bashkinë e Kuksit, në Bashkinë e Shkodrës, Devollit dhe Vorës.** Në **Bashkinë e Lushnjës** përveç paketave ushqimore është ofruar shërbim shëndetësor për viktimat si dhe pajisja me medikamentet e nevojshme.

**Bashkia Rrogozhinë** raporton specifikisht që përveç kujdesit shëndetësor të mbijetuarave të dhunës iu është ofruar edhe ndihmë nga ana e psikologut për rehabilitim dhe përmirësim të shëndetit mendor dhe fizik. Të njëjtën ndihmë psikologjike ka ofruar dhe Bashkia Fushë Arrëz, Pukë, Sarandë dhe Kurbin duke ju vendosur në dispozicion të mbijetuarave të dhunës asistencë për gjendjen e tyre psikologjike. Edhe Bashkia Këlcyrë, Finiq, Roskovec dhe Divjakë informojnë se pavarësisht numrit jo shumë të rritur të rasteve të raportuara të dhunës kanë mundur që të ndihmojnë të mbijetuarat nëpërmjet shërbimit psikologjik të ofruar nga Bashkia.

**Në Bashkinë e Elbasanit dhe Tiranës** ka munguar ofrimi i kujdesit shëndetësor, në krahasim me bashkitë e tjera që paraqesin me numra më të vegjël të rasteve të dhunës si **Saranda apo Kurbini** të cilat përveç kujdesit shëndetësor kanë ofruar dhe asistencë psikologjike për rastet e dhunës.

Sipas raportimit të realizuar nga ana e Bashkive ndihmesa e Oganizatave të Shoqërisë Civile ka qenë një nga faktorët më të rëndësishëm për ndihmesën dhe rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës.

**Mbështetja Psikologjike** është një nga elementët më të rëndësishëm që i është ofruar të mbijetuarave nga ana e organizatave të shoqërisë civile në kushtet kur ka patur mangësi në ofrimin e këtij shërbimi nga ana e bashkive. Shërbim Psikologjik është ofruar nga ana e OJF në Bashkinë Kamëz, Rroskovec, Tiranë, Rrogozhinë, Kucovë, Pukë, Selenicë, Himarë, Vlorë, Shijak, Konispol, Belsh, Kurbin, Lezhë, Këlcyrë, Delvinë dhe Shkodër.

## KËSHILLIM LIGJOR

**43** Bashki kanë ofruar shërbimin ligjor për nevojat e paraqitura nga ana e të mbijetuarave të dhunës. Ndër Bashkitë që e kanë ofruar këtë shërbim përmendim Bashkinë Has, Mat, Tropojë, Mallakastër, Librazhd, Shkodër, Delvina, Lushnjë, Finiq, Kavajë, Bulqizë, Dibër, Lezhë, Gjirokastër, Elbasan, Mirditë, Belsh, Konispol, Maliq, Korçë, Shijak, Malësi e Madhe, Vlorë, Sarandë, Selenicë, Fier, Patos, Ura Vajgurore, Fushë Arrëz, Krujë, Berat, Poliçan, Cërrik, Kuçovë, Rrogozhinë, Divjakë, Pustec, Vau i Dejës, Prrenjas, Kaméz.

Bashkitë: Tiranë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Kukës, Peqin, Kurbin, Skrapar, Pogradec, Dropull, Himarë, Pukë, Klos **nuk kanë ofruar asistencë dhe ndihmë ligjore në vitin 2021 për rastet e dhunës**. Pavarësisht se këto bashki raportojnë për numra jo të rritur të rasteve të dhunës, ndihma ligjore duhet të jetë e mundur për cilindo që ka nevojë. Nga ana tjetër bashkitë me raste të rritura të dhunës në familje si Elbasani (125 raste konsulence ligjore), Fieri, Shkodra, Kruja, etj, raportojnë për asistencë ligjore të kryer ndaj personave në nevojë.

Referuar Konventës së Stambollit në nenin 20 parashikohet se "Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që të mbijetuarat të kenë akses **në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna.** Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime, të tilla si: **konsulenca ligjore** dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune. Ndihma juridike e ofruar nga bashkia do të lehtësojë pozitën e të mbijetuarave të dhunës si dhe do të rehabilitojë në jetën e përditshme atë dhe familjen. Konsulenca ligjore është një nga mbështetjet më të mëdha, që mund t'u ofrohet të mbijetuarave nga pushteti lokal. Kuadri ligjor në sferën e aksesit në drejtësi është përmirësuar. Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", i cili hyri në fuqi nga 1 qershor 2018, zgjeroi kategorinë e grave vulnerabël që mund të përfitojnë ndihmë juridike. Referuar monitorimit në krahasim me vitin 2020 jo të gjitha rastet e dhunës në familje janë të asistuara nga ana ligjore duke dhënë informacion apo duke ndjekur rastet e dhunës.

Gjithashtu për Bashkitë e Kamëz, Rroskovec, Tiranë, Rrogozhinë, Kuçovë, Berat, Selenicë, Himarë, Mirditë dhe Fieri është ofruar **asistencë ligjore** falas nga **Organizatat e Shoqërisë Civile** për viktimat e dhunës për ndjekjen e proceseve ligjore për të rivendosur në vend të drejtat e tyre të shkelura nga ana e dhunuesit.



## SHËRBIME PËR RAPORTIMIN E DHUNËS NË SITUATË EMERGJENCE (LINJA TELEFONIKE LOKALE, MEDIA SOCIALE ETJ).

**40** Bashki kanë marrë masa për vendosjen në dispozicion të komunitetit të mjeteve të raportimit të dhunës në situatë emergjence (linja telefonike, media sociale etj). Ky detyrim i bashkisë rrjedh nga parashikimet e Vendimit nr. 327, datë 2.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës", ku **rast urgjent,** është cilësuar rasti kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit dhe merren masa paraprake të menjëhershme për mbrojtjen e të mbijetuarave, për ndalimin e dhunës dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të saj.

**Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konvenat e Stambollit), miratuar në Stamboll më, 11.05.2011 përcakton se:** "Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur linja telefonike falas të ndihmës mbarëkombëtare të pandërprerë (24/7) për të ofruar konsulencë për telefonuesit, fshehtësi ose respektim të anonimatit të tyre, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj.
Gjatë monitorimit tonë vërejmë se detyrimi për akses në kushte urgjence mungon në rreth gjysmën e bashkive të vendit tonë. Bashkitë si: Hasi, Tepelena, Tropoja, Mallakastra, Memaliaj, Përmeti, Shkodra, Delvinë, Lushnjë, Këlcyrë, Finiq, Kavajë, Bulqizë, Lezhë, Gjirokastër, Elbasan, Konispol, Maliq, Mat, Korçë, Shijak, Pogradec, Malësi e Madhe, Selenicë, Patos, Ura Vajgurore, Fushë Arrëz, Krujë, Berat, Poliçan, Kuçovë, Cërrik, Rrogozhinë, Vau i Dejës, Prrenjas dhe Kamëz **kanë ofruar shërbimin online të raportimit.**

Bashkia Kamëz raporton se gjatë periudhës së pandemisë dhe në vazhdim në bashkëpunim me UNDP është ndërmarrë nisma për publikimin e numrit të shërbimit social i afishur në çdo lagje/NJA, në media sociale për të raportuar në çdo kohë dhunën në familje.

Mungesa e linjës online në Bashkinë e Tiranës apo Fierit, si dy nga bashkitë me numër më të madh rastesh të raportuara dhune ka sjell një vështirësi të të mbijetuarave të dhunës në raportim të emergjencës.

Bashkia Tiranë gjithashtu raporton një bashkëpunim të ngushtë **me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza** e cila ofron edhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem si një nevojë e domosdoshme e evidentuar nga shumica e bashkive të vendit. Kjo bashki evidenton edhe bashkëpunimin me UNOPS, UNFPA DHE UN Women si dhe Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci.

Në total janë realizuar **3469 telefonata për këtë periudhë 12-mujore.** Gjatë vitit 2021 në Linjën Kombëtare të Këshillimit janë pritur 3269 telefonata nga mbarë vendi dhe janë kryer **827 seanca këshillimi ballë për ballë.** Gjithashtu, është ofruar shërbim i specializuar i asistensës ligjore, si parësore ashtu edhe dytësore, **për 742 gra në total.** Telefonatat kanë ardhur nga mbarë vendi, por numri më i madh i telefonatave ka ardhur nga banuese të Qarkut Tiranë.

Gjatë periudhës së raportimit dhuna e ushtruar ndaj klienteve që kanë telefonuar ose kanë marrë këshillim ballë për ballë ka qenë kryesisht e natyrës psikologjike (56%), fizike (48%), ekonomike (33%) dhe seksuale (8 raste) .

Asistenca ligjore **Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem** për periudhën janar – dhjetor 2021 ka trajtuar 87 raste dhunuesish në familje, të cilët nuk kanë patur recidivizëm. Gjithashtu ka organizuar 90 workshope në gjimnaze të ndryshme dhe 2 workshope gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit.

## SHËRBIME TË FORMIMIT PROFESIONAL DHE PUNËSIMIT

Shërbimet e formimit profesional janë një mundësi më shumë për reintegrimin e të mbijetuarave të dhunës në jetën e përditshme. Këto mundësi, që bashkia duhet të ofrojë ndikojnë jo vetëm në jetën individuale të cilitdo që përfiton nga shërbimet por edhe përmirësim e cilësisë së jetës së komunitetit duke rritur numrin e shërbimeve të ofruara brenda bashkisë. Nga monitorimi i bashkive është vënë re se:

**28**

Bashki ofrojnë për të mbijetuarat e dhunës shërbime të formimit profesional dhe punësim. Bashkia Korçë raporton edhe si rast suksesi integrimin e një zonje duke i ofruar kurs profesional për rrobaqepëse, i cili i shërbeu të hapte një biznes të vogël pas përfundimit të një kursi. Në Bashkinë Berat kurset falas janë ofruar nga OJF të ndryshme në bashkëpunim me bashkinë duke mundësuar reintegrimin e të mbijetuarave të dhunës si dhe gjatë takimeve të ETN-së është diskutuar për mbështetjen dhe fuqizimin e rasteve në vazhdim, ndërmjetësim për punësimin e tyre. Për vitin 2021 Bashkia e Beratit ka punësuar 6 vajza dhe gra në Zyrën e Pastrimit të Qytetit duke e raportuar si një praktikë të mirë për t'u ndarë me bashkitë e tjera.

Nga ana tjetër **Bashkia Pogradec** raporton me shqetësim mungesën e ofrimit të kurseve profesionale për shkak të mungesës së stafit në Qendrën e emergjencës në Pogradec. Bashkitë që ofrojnë kurse profesionale shpesh herë janë me numër të vogël banorësh si **Tepelenë, Shijak, Maliq, Konispol, Selenicë, Vau i Dejës, Divjakë, Cërrik, Klos, Rrogozhinë, Patos.** Gjithashtu shërbimet profesionale i ofrojnë edhe bashki të mëdhaja shumica prej të cilave raportojnë rase të rritura dhune si Bashkia **Vlorë, Elbasan, Shkodër, Dibër, Lezhë, Mallakastër, Tropojë, Fier, Pukë, Krujë.**

## PROGRAME TË STREHIMIT AFATGJATË

**24** Bashki mundësojnë shërbimin e strehimit afatgjatë, nëpërmjet së cilit ndihmojnë të mbijetuarat e dhunës të akomodohen në banesa të ndarë nga dhunuesit. **Bashkia Berat** ka mundësuar mbështetje me strehim afatgjatë nëpërmjet përfshirjes në projekte apo ofrimin e banesave sociale. Gjithashtu **Bashkia Patos** ka ofruar për vitin 2021 veç shërbimeve të tjera edhe strehimin afatgjatë për rastet e evidentuara si kandidatë që plotësojnë kushtet ligjore për të përfituar këtë mbështetje. **Bashkia Fier,** edhe pse me një numër të lartë të rasteve të dhunës nuk ka ofruar asnjë rast mbështetjeje me strehim afatgjatë, ndërkohë **Bashkia Vlorë,** edhe pse me një numër më të ulët të rasteve të dhunës në krahasim me Fierin ka ofruar strehim afatgjatë për të mbijetuarat e dhunës. **Bashkia Korçë** ka ofruar strehim si dhe ka kryer informimin e vazhdueshëm në lidhje me mundësinë për të përfituar nga kriteret e strehimit afatgjatë. **Bashkia Elbasan** raporton se gjatë vitit 2021 janë përfshirë në programin e bonusit të qerasë 15 raste. Gjithashtu në **Bashkinë e Lezhës** strehimi afatgjatë është ofruar në bashkëpunim me OJF-të.

Strehim afatgjatë është ofruar edhe në **Bashkinë e Shkodrës, Tropojës dhe Hasit, Delvinës, Prrenjasit, Rrogozhinës, Poliçanit, Urës Vajgurore, Sarandës, Malësisë së Madhe, Finiqit, Gjirokastrës, Lushnjës e Kukësit, Kolonjës (e cila ofron vetëm këtë shërbim).**

Nga një analizë e shkurtër rezulton se: Bashkia Tiranë, Malllakastër apo Bashkia Memaliaj edhe pse kanë një rritje të lartë të rasteve të dhunës së raportuara nuk e ofrojnë shërbimin e strehimit afatgjatë, fakt i cili mundëson rritjen e riskut për të mbijetuarat e dhunës përsa kohë nuk iu ofrohet për strehim një mjedis jo i përbashkët me dhunuesin.

Strehimi afatgjatë është një nga problematikat më të shpeshta të hasura në të gjitha bashkitë. Nëse i referohemi Ligjit Nr. 22/2018 "PËR STREHIMIN SOCIAL", parashikohet se banesat e specializuara janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifike strehimi, në të cilat përfshihen edhe banesat për të mbijetuarat e dhunës në familje. Pavarësisht se ligji iu ka dhënë përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit, gjithsesi kjo është një përpjekje e pamjaftueshme për të ndihmuar të mbijetuarat e dhunës të qëndrojnë larg dhunuesit dhe të reintegrohen. Nga monitorimi i shërbimeve të ofruara nga bashkitë, rezulton se ky është shërbimi më pak i ofruar dhe e drejta më pak e garantuar në favor të të mbijetuarave të dhunës.

**25** Programe të tjera parandaluese kanë ndërmarë qytete si Kavaja, Kukësi, Lezha, Gjirokastra, Shkodra, Delvina, Vlora, Himara, Selenica, Maliqi, Korça, etj.

# I.3 KËNDVËSHTRIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË NIVEL VENDOR

Cilësia e shërbimeve sociale në Bashki dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore



Rritja e cilësisë së shërbimit në nivel vendor, ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve bazuar kjo edhe në parimin e subsidiaritetit, të cilin legjislacioni e ka përfshirë në aktet ligjore e nënligjore të pushtetit vendor (Parimi i Subsidiaritetit) sipas së cilit shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore. Nga të dhënat e përfituara nga takimet me fokus grupe, grupet e interesit dhe përfituesit e shërbimeve si dhe OJF rezulton se shërbimet e ofruara nga Njësia Administrative dhe bashkia janë në nivelin, rezulton se niveli shërbimeve të ofruara:

Cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia për vitin 2021 është renditur si më poshtë:

1. Në nivelin "Shumë mirë" janë kategorizuar vetëm në 9 Bashki si Prrenjas, Sarandë, Konispol, Gjirokastër, Bulqizë, Shkodër, Librazhd, Përmet dhe Pustec.
2. Në nivelin "Mirë" janë vlerësuar 23 Bashki ndër të cilat përmendim Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Peqin, Fier, Selenicë, Himarë, Tropojë, Mallakastër, Finiq, Delvinë, Maliq, Kavajë, Kukës, Elbasan, Mirditë, Cërrik, Malësi e Madhe, Dropull, Vlorë, Berat, Vau i Dejës, Belsh.
3. Në nivelin "Jo mirë" janë vlerësuar 5 Bashki si Has, Kurbin, Pukë, Tiranë, Fushë Arrëz.
4. Në nivelin "Neutral" janë vlerësuar 5 bashki si Skrapar, Dibër, Lezhë, Ura Vajgurore dhe Poliçan.
5. Në nivelin "Aspak mirë" janë vlerësuar vetëm 2 bashki si Bashkia e Matit dhe Bashkia e Kuçovës.

## CILAT JANË MANGËSITË QË PARAQESIN BASHKITË NË KËNDVËSHTRIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE:

- Në Bashkinë Has evidentohet si problem thelbësor ndërrimi i shpeshtë i personelit përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.
- Në Bashkinë Tropjë mungon KV. Problematikë tjetër që mund të përmendet është ndërrimi i shpeshtë i punonjësëve përgjegjës për DHF & DHBGJ në nivel bashkie.
- Në Bashkinë Lezhë ka mungesë fondesh dhe shërbimesh për fëmijët e të mbijetuarave të dhunës. Mungon asistenca psikologjike.
- Në Bashkinë Librazhd ka mungesë të fondeve të veçanta për trajtimin e DHF dhe DHBGJ.
- Në Bashkinë Shkodër, nevojitet të punësohen 2 Koordinatorë Vendorë ndërkohë që aktualisht nuk është punësuar asnjë i tillë.
- Në Bashkinë Mallakastër mungon një strehëz sociale ditore për rastet e emergjencës dhe staf i dedikuar për shërbimin psiko-social. Mungon një paketë ekonomike mbështetëse për viktimat e dhunës.
- Në Bashkinë Finiq mungojnë juristë dhe psikologë të specializuar/çertifikuar për mbështetje psikologjike dhe juridike për të mbijetuarat. Bashkia nuk ofron trajtim / këshillim / ndihmë të specializuar psikologjike për burrat dhunues.
- Në Bashkinë Delvinë: Mungon një zgjidhje afatgjatë për të mbijetuarat e dhunës. Rastet për akomodim në strehëz emergjente dërgohen në Sarandë.
- Në Bashkinë Selenicë: Ofrimi i programeve te strehimit social dhe mundësi punësimi për të mbijetuarat e dhunës në familje.
- Në Bashkinë Himarë: Mungon strehimi afatgjatë, mungon mbështetja për rritjen e fëmijëve të nënave të mbijetuara të dhunës në familje.
- Në Bashkinë Përmet, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Dropull: Mungojnë specialistët me eksperiencë dhe të licencuar si punonjës socialë ose psikologë.

- Bashkia Peqin, Cërrik dhe Belsh: Edhe pse evidentohet se shërbimet sociale të ofruara për adresimin e DHF & DHBGJ nga institucionet vendore janë thuajse në rregull, problemi vetëm qëndron tëk cilësia e shërbimeve dhe kjo si pasojë e mungesës së financimit.
- Bashkia Mat: Mungojnë burimet njerëzore, mbështetja financiare, mekanizmat dhe një vullnet politik i drejtuesve.
- Në Bashkinë Ura Vajgurore: Edhe pse së fundmi ka një investim për ngritjen e qendrës multifunksionale e pajisur me staf të dedikuar për shërbime të ndryshme sociale, ka nevojë për rritje buxheti si dhe përmirësim infrastrukturës për identifikimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës.
- Bashkia Poliçan evidenton mungesën e një stafi të kualifikuar në fushën e dhunës në familje dhe barazisë gjinore si dhe mungesën e qendrës së emergjencës.
- Në Bashkinë Fier pavarësisht se shoqata Vatra ka punuar me qëllim forcimin e marrëdhënieve midis strukturave lokale shtetërore dhe joshtetërore të MKR në Fier duke organizuar takime konsultative, trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të këtyre strukturave për çështjet e trafikimit dhe dhunës, përsëri ka nevojë të rritet zëri i buxhetit social në buxhetin e bashkisë, si dhe të përmirësohet infrastruktura për stafin për identifikimin e monitorimin e rasteve të dhunës.
- Bashka Skrapar thekson mungesën e rritjes së kapaciteteve të punonjësve që ofrojnë shërbimet për trajtimin e rasteve të dhunës.
- Bashkia Fushë Arrëz evidenton mungesën e Koordinatorit për Dhunën në Familje dhe DHBGJ si dhe mungesën e strehëzës së emergjencës.
- Bashkia Vau i Dejës evidenton mungesën e strehës së emegjencës dhe mungesën e ofrimit të banesave sociale.
- Në Bashkinë e Tiranës mungojnë shërbimet afatgjata që duhet t'u ofrohen të mbijetuarave të dhunës si rehabilitim, strehim apo reintegrim në shoqëri për të mbijetuarat e dhunës.
- Në Bashkinë Berat konstatohet mungesa e buxhetit, si dhe infrastruktura e duhur për aksesin në të gjithë territorin.
- Në Bashkinë Pukë mungon koordinatori i dhunës në familje, mungon strehëza e emergjencës.
- Në Bashkinë Prrenjas ka nevojë të përmirësohet mbështetja për strehim.
- Në Bashkinë Sarandë evidentohet mungesa e strehimit afatgjatë për të mbijetuarat e dhunës.
- Në Bashkinë Vlorë evidentohet mungesa e strehimit afatgjatë si dhe mungesa e punësimit për të mbijetuarat e dhunës.
- Në Bashkinë e Malësisë së Madhe dhe Bashkinë Konispol mungon strehëza emergjente, banesat sociale apo bonusi i qerasë për të mbijetuarat e dhunës.
- Në Bashkinë Kurbin evidentohet mungesa e një fondi të posaçëm për çështjet e dhunës si dhe ndërgjegjësimi i komunitetit.
- Bashkia Mirditë ka një mungesë të strukturave për menaxhimin e rasteve emergjente të dhunës si dhe një staf më të angazhuar për ofrimin e shërbimeve.
- Bashkia Elbasan evidenton mungesën e një strehimi afatgjatë për të mbijetuarat e dhunës.
- Bashkia Gjirokastër evidenton mungesën e kualifikimit të punonjësve në shërbimin social si dhe nevojën për rritje kapacitetesh.
- Në Bashkinë Dibër ka mungesë të buxhetit për ofrimin e shërbimeve, burime njerëzore për menaxhimin e rasteve të dhunës, strehëzës së emergjencës, këshillimit ligjor, mbështetjes psikologjike, etj.
- Në Bashkinë Bulqizë evidentohet nevoja për sensibilizim të komunitetit, në lidhje me të drejtat e tyre dhe parashikimet ligjore në rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Në Bashkinë Kavajë mungojnë shërbimet multidisiplinore si dhe integrimi ekonomik dhe social i të mbijetuarave të dhunës.

## PËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJEN E BASHKIVE E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE TË CILAT KANË NË FOKUS DHUNËN NË FAMILJE DHE DHUNËN ME BAZË GJINORE:

Qëndrimi i organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë në fokus dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore në lidhje me përfshirjen e tyre në vendimmarrjet e bashkisë, tregon se më shumë se gjysma e tyre janë shumë të përfshira në vendimmarrjet e Këshillave Bashkiake të Njësive të Qeverisjes vendore. Bashkia Pukë, Mat, Fushë Arrëz dhe Malësi e Madhe rezultojnë, sipas këndvështrimit të OSHC-ve, më pak përfshirëse ndaj organizatave të cilat ushtrojnë veprimtarinë në njësitë e tyre territoriale. Nga ana tjetër Bashkia Malësi e Madhe ka raportuar se ka një mungesë të theksuar të shërbimeve të OJF-ve në ndihmë të të mbijetuarave të dhunës.

Ndërkohë organizatat janë shprehur që kanë qenë shumë të përfshira në Bashktë Berat, Fier, Përmet, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, etj duke i cilësuar dhe si praktika të mira bashkëpunimi në luftën kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore për shkak të bashkëpunimeve të vazhdueshme.



# KAPITULLI 2

## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS

### 2.1. POLICIA E SHTETIT:

Policia është pika e parë e kontaktit, si në rastin kur e mbijetuara (apo një i afërm, ose komshi, apo kalimtar) kërkon ndihmë (apo denoncon) nëpërmjet telefonit, ashtu dhe kur e mbijetuara paraqitet direkt në ambjentet e policisë. Ndërkohë, pavarësisht nëse është duke shkuar për në vendngjarje apo nëse e takon të mbijetuarën në ambjentet e policisë, njofton menjëherë KVDHF dhe kërkon praninë e tij/saj për të filluar me procesin e vlerësimit të riskut. Punonjësi i policisë në bashkëpunim me KVDHF/punonjësen sociale dhe PMF kur bëhet fjalë për fëmijët kryen vlerësimin e riskut me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e viktimës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin. Punonjësi i policisë do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat përkatëse për përgatitjen e dosjes për lëshimin e Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM). Policia e shtetit është aktor kyç në zbatimin dhe monitorimin e urdhërave të mbrojtjes dhe bashkëpunon ngushtësisht me KVDHF dhe institucionet e tjera anëtare të ETN-së, për menaxhimin me sukses të rastit të dhunës në familje.

Raporti i bashkive me policinë e shtetit për menaxhimin e rasteve të dhunës në familjje dhe dhunës me bazë gjinore për vitin 2021, raportohet si më poshtë:

1. Në **Bashkinë e Hasit** ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me policinë e shtetit ku përfaqësuesit e kësaj bashkie kanë realizuar në vazhdimësi plotësimin e kërkesë padive për UMM, UM dhe raportin e vlerësimit të riskut.
**Bashkia Tepelenë** raporton një Bashkëpunim të vazhdueshëm me policinë e shtetit duke theksuar faktin se të gjitha të mbijetuarat e dhunës janë shoqëruar dhe marrë në mbrojtje nga policia duke i asistuar në çdo rast me punonjëset sociale, gjatë procesit të marrjes në pyetje, këshillimit, dhe hartimit të dokumentacionit, për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes në gjykatë. Njëkohësisht edhe **Bashkia e Tropojës** raporton se Policia e Shtetit ka transportuar në mënyrë të sigurt viktimat e dhunës.
**Bashkia Mallakastër** e cila raporton një dyfishim të rasteve të dhunës për vitin 2021 për 3 raste, të mbijetuara të dhunës në familje, raporton se Policia e Shtetit i ka shoqëruar dhe marrë në mbrojtje.
Përveçse janë asistuar në çdo rast me punonjëset sociale, gjatë procesit të marrjes në pyetje, këshillimit, dhe hartimit të dokumentacionit, për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes në gjykatë.
**Bashkia Memaliaj** raporton për një bashkëpunim të vazhdueshëm për rastet e dhunës me Policinë e Shtetit, të mbijetuara të dhunës në familje, duke i shoqëruar me punonjësit e policisë, në çdo rast edhe me punonjësen sociale, gjatë marrjes së ndihmës mjekësore, në spitalin zonal.
**Bashkia Përmet, Librazhd, Lushnjë, Kavajë, Dibër, Mirditë, Peqin, Ura Vajgurore dhe Elbasan** raportojnë për një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me policinë e shtetit. Ndërhyrja e menjëhershme dhe profesionale në vendngjarje dhe mbrojtja e të mbijetuarës.

Në **Bashkinë e Shkodër,** bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është fokusuar jo vetëm në rastet e raportuara për dhunë por edhe në monitorimin e të mbijetuarave të dhunës në territorin e Bashkisë Shkodër.

Në **Bashkinë e Delvinës** raportohet për një bashkëpunim korrekt me policinë e shtetit për çdo rast, duke i asistuar në pyetje, këshillim, dhe hartim të dokumentacionit, të mbijetuarat e dhunës janë asistuar nga punonjësja sociale dhe juristi i bashkisë.

**Bashkia Këlcyrë** për vitin 2021 raporton për një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Shtetit duke evidentuar se strukturat e policisë në një rast emergjent janë përgjigjur në mënyrë të shpejtë dhe profesioniste duke bërë të mundur kapjen në flagrancë të dhunuesit.

**Bashkia Finiq** gjithashtu raporton për një bashkëpunim shumë të mirë dhe efikas me policinë e shtetit, ku evidenton se për të 2 rastet e të mbijetuarave të dhunës në familje janë kryer procedime si Arrest me burg 6 muaj, për një nga dhunuesit dhe janë marrë në mbrojtje të dyja të mbijetuarat. Janë asistuar në çdo rast nga koordinatorja vendore dhe psikologu, gjatë procesit të marrjes në pyetje, këshillimit, dhe hartimit të dokumentacionit, për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes në gjykatë.

**Bashkia Bulqizë Bashkia Klos, Bashkia Pukë dhe Bashkia Kuçovë, Kurbin Pustec** raportojnë për një bashkëpunim profesional me Policinë e Shtetit duke kryer procedura korrekte për rastet si: Intervistim të rastit, referimi pranë bashkisë, dhe bashkëpunim për realizimin e kërkesave për UNM/UM, referim, plotësimi i kërkesës për UM, monitorim i rasteve.

Në **Bashkinë e Kukësit** Policia e Shtetit ka bashkëpunuar me strukturat e Bashkisë duke lëshuar UMPMM, duke mbështetur dhe transportuar viktimat e dhunës drejt vendbanimeve të sigurta si strehëza, qendra, në rastet e nevojshme.

Në **Bashkinë Lezhë** ka patur bashkëpunim të ngushtë me policinë për identifikim, informim, vlerësim risku, transport i sigurtë, si dhe janë lëshuar UMPMM, për siguri për të mbijetuarën.

**Bashkia e Gjirokastrës** raporton se Policia e Shtetit referon rastet e dhunës dhe bashkëpunon me strukturat e Bashkisë.

**Bashkia Cërrik,** evidenton Policinë e Shtetit si të vetmin institucion efektiv, i cili referon dhe adreson problematikat e të mbijetuarave të dhunës në familje pranë sektorit social të bashkisë.

**Bashkia Skrapar** ka bashkëpunuar në mënyrë të frytshme me Policinë e Shtetit dhe evidenton se gjatë 2021 janë lëshuar 10 Urdhra Mbrojtjeje dhe janë mbikqyrur në mënyrë të rregullt. Përfaqësues të Policisë Skrapar kanë qenë në të gjitha mledhjet e MKR.

**Bashkia Konispol, Maliq dhe Patos, Mat, Kolonjë** raportojnë për raste të vlerësimit të riskut nga ana e Policisë së Shtetit, marrja e kallzimeve si dhe kërkesave për UM, plotësim i kërkesë padisë për UMM/UM.

**Bashkia Korçë** raporton se Policia e Shtetit ka qenë mbështetje kryesore në adresimin e dhunës në familje si institucioni i parë ku raportohet rasti, plotëson kërkesë padinë, ka realizuar vlerësimin e riskut në bashkëpunim me koordinatorin.

**Bashkia Shijak** raporton për asistim, ofrim i sigurisë së të mbijetuarës, sigurim transporti në strehëz, lëshim UMP.

**Bashkia Pogradec** raporton se Policia e shtetit në bashkëpunim me strukturat e bashkisë për vitin 2021 kanë hartuar Kërkesë padi për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhër Mbrojtje, Urdhër paraprak Mbrojtje për situatat e nivelit të lartë të riskut.

**Bashkia e Malësisë së Madhe** në bashkëpunim me Policinë e Shtetit evidenton raportimin e vazhdueshëm që bën policia për secilin rast të denoncuar.

Bashkëpunimi i **Bashkisë Dropull** me policinë e shtetit ka qenë vetëm për organizimin e takimeve sensibilizuese nëpër shkolla.

**Bashkia e Vlorës** raporton për një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit në procesin e hartimit të kërkesë padive, vleresimit të riskut, kërkesë padi për UMM dhe UM, këshillim , si edhe transport i të mbijetuarave drejt strehëzave Sarandë: Policia e shtetit bën vlerësimin e riskut, kërkesë padi për UMM dhe UM, transport i të mbijetuarave drejt strehëzave.

**Bashkia Selenicë** raporton se Policia e shtetit ka kryer në bashkëpunim me bashkinë, vlerësimin e riskut, kërkesë padi për UMM dhe UM, këshillim, transport i të mbijetuarava drejt strehëzave, etj.

**Bashkia e Fierit** raporton se Policia e Shtetit ka bashkëpunuar me bashkinë në procesin e vlerësimit të riskut, monitorimin e UM, si dhe menaxhimet e rasteve të dhunës kryesisht në mbrojtjen e të mbijetuarave.

**Bashkia Fushë Arrëz** raporton për bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit e cila për vitin 2021 ka ndihmuar në proces duke shoqëruar dhe ruajtur të mbijetuarat e dhunës.

**Bashkia e Krujës** raporton se Policia e Shtetit për vitin 2021 ka raste të ndërhyrjeve në vendngjarje si dhe ka siguruar të mbijetuarën.

**Bashkia Kamëz** raporton se Policia ofron mbrojtje të të mbijetuarave, bashkëpunim me KVDHF në plotësimin e kërkesë-padive për UMM/UM, shoqërimin e të mbijetuarave drejt shërbimeve si banesë, gjykatë, strehëz, monitorim të rastit në banesë së bashku me KVDH/punonjësin social.

**Bashkia Prrenjas** shprehet se policia ndihmon procesin kundër dhunës duke referuar çdo rast.

**Bashkia e Beratit** raporton se bashkëpunimi me Policinë e Shtetit ka qenë shumë i mirë, ku në zbatim të legjislacionit janë kryer të gjitha procedurat e Vlerësimit të riskut dhe hartimit të Kërkesë-padive për të gjitha viktimat e dhunës në familje drejtuar në Komisariat. Inspektorët e zonës kanë orientuar të gjitha viktimat të drejtohen në zyrën e KDHF-së bashki për mbështetje të mëtejshme. Gjithashtu policia ka bërë gjithmonë të mundur shoqërimin e të mbijetuarave dhe transportimin e tyre në mjedise të sigurta, në strehëza apo banesa. Pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta kundër dhunës në familje dhe dhunës më bazë gjinore.

**Bashkia e Roskovecit** ka gjetur ndihmën e policisë së shtetit në plotësimin e kërkesë padive dhe monitorimin e urdhërave të mbrojtjes.

Në **Bashkinë e Vaut të Dejës** ku numri i rasteve të raportuara të dhunës është trefishuar policia ka plotësuar procedurën për urdhrat paraprake të mbrojtjes.

**Bashkia Divjakë** e evidenton ndërhyrjen emergjente të policisë së shtetit shumë profesioniste në të gjitha rastet e raportimit të dhunës duke pamundësuar edhe rrezikun për të mbijetuarat gjatë dhunës. Sjellim në vëmendje se Bashkia Divjakë ka një numër të dyfishuar të rasteve të raportuara të dhunës për vitin 2021.

**Bashkia Devoll** evidenton se Policia e shtetit raporton për hartimin e Kërkesë Padive, UMPMM, shoqërimin e të mbijetuarave dhe plotësimin e raportit të riskut.

**Bashkia Rrogozhinë** raporton se policia e shtetit ka reaguar menjëherë për të gjitha thirrjet emergjente, duke plotësuar dokumentacionin si dhe ka transportuar të mbijetuarat drejt një vendi të sigurt. Reagim i menjëhershëm për thirrjet telefoniket duke bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatoren e dhunës në bashki.

**Bashkia Durrës** raporton se shërbimet e policisë realizojnë kërkesëpaditë, UMPMM, shoqërimin e të mbijetuarave dhe plotësimin e raportit të riskut.

***33 Organizata të cilat operojnë në Bashkitë e vendit mendojn se cilësia e punës së policisë duhet përmirësuar në raport me menaxhimin e rasteve të dhunës.***

# 2.2. SHËRBIMET SOCIALE NË NIVEL BASHKIE DHE NIVEL NJËSIE ADMINISTRATIVE

Me miratimin e Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", është synuar mbulimi i shërbimeve të përkujdesit social dhe ngritur një Fond Social si një linjë e ndarë buxhetore për të financuar këto shërbime, që transferohen te njësitë e qeverisjes vendore (NJQV).

Ligji ka përcaktuar jo vetëm rolin e bashkisë në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe strukturat që duhet të ngrihen e të funksionojnë si pjesë e saj, me qëllim që të bëhet funksional një sistem lokal komunitar i këtyre shërbimeve. Në këndvështrimin e ligjit, bashkia duhet të ketë struktura të ngritura në dy nivele:

a) Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki;

b) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, e krijuar në nivelin e njësive administrative.

Rolet dhe funksionet e këtyre dy strukturave, që duhet të ngrihen në dy nivele të ndryshme të organizimit të bashkisë, në thelb duhet të jenë të ndryshme. Struktura përgjegjëse në nivelin e bashkisë duhet të ketë role dhe funksione që lidhen me drejtimin strategjik, planifikimin e shërbimeve, monitorimin, prokurimin e tyre, mbështetjen e strukturave të NJVNR me kapacitete, si dhe si një urë lidhëse mes këtyre të fundit dhe lidershipit vendimmarrës të bashkisë, në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë). NJVNR duhet të jetë struktura zbatuese e politikave sociale lokale e kombëtare, duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për individët në nevojë. Në mënyrë më të hollësishme, detyrat e strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, të krijuar pranë bashkisë, duhet të jenë:

a) Identifikimi i nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë.

b) Vlerësimi i nevojës për shërbime të kujdesit shoqëror, sipas hartës së vulnerabiliteti

c) Hartimi i Projektplanit Social vendor duke kostuar shërbimet e nevojshme të identifikuara, si dhe përgatitja e Programit Buxhetor vjetor dhe afatmesëm përkatës, për miratim në Këshillin Bashkiak.

ç) Planifikimi i kalendarit të shpërndarjes vjetore dhe sigurimi i ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjatë një viti. d) Ofrimi i shërbimeve shoqërore nëpërmjet:

i) kontraktimit të realizimit të shërbimeve nga sektori privat;

ii) krijimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve publike.

dh) Ngritja dhe zbatimi i sistemit të administrimit të performancës së shërbimit, bazuar në standarde vendore dhe standarde ministrie kombëtare, të cilat miratohen me Udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

e) Hartimi dhe zbatimi i sistemit të treguesve për matjen e performancës, në të cilin përfshihen edhe tregues të aspektit gjinor.

ë) Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes së shërbimeve në territorin e bashkisë.

f) Propozimi i përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për miratim nga Këshilli Bashkiak.

Kjo strukturë kryen edhe funksione që lidhen me: a) Administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, në përputhje me Ligjin Nr. 9355 (i ndryshuar) për ndihmën ekonomike. b) Mbrojtjen e fëmijëve, në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve". c) Masat për mbrojtjen nga dhuna në familje, në përputhje me Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar.

Në çdo njësi administrative në varësi të bashkisë, me përjashtim të bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, e cila, në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të ketë këto detyra kryesore: a) Identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë.

b) Vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë.

c) Informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla.

ç) Hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes.

d) Bashkërendimin e mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimin te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm.

dh) Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit.

e) Mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar.

ë) Hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016.

f) Aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:

a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë;

b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë; c) administrator shoqëror. Çdo punonjës i kësaj njësie ka detyra specifike, që burojnë nga legjislacioni dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë fushën specifike që ata mbulojnë. Detyrat e tyre janë specifikuar qartë në Udhërrëfyesit e përgatitur për secilin prej punonjësve të kësaj njësie.

**NËPËRMJET TABELËS SË MËPOSHTME JANË PASQYRUAR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI SOCIAL NË NIVEL BASHKIE DHE SHËRBIMI SOCIAL NË NIVEL NJËSIE ADMINISTRATIVE PËR BASHKITË E VENDIT.**

| BASHKIA | SHËRBIM SOCIAL NË NIVEL BASHKIE | SHËRBIM SOCIAL NË NIVEL NJËSIE ADMINISTRATIVE |
|---|---|---|
| Bashkia Has | Është asistuar në plotësimin e kërkesë padisë për UMM, UM, raportin e vlerësimit të riskut, informacion mbi bazën ligjore, shërbim psikologjik, ligjor, paketa ushqimore, transportimin e rasteve në qendrat e rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje, marrja pjesë në seancat gjyqësore për UMM, UM si dhe monitorimi i UM. | Dhënia e ndihmës ekonomike për rastet, si dhe menaxhimi i rastit nga NJMF kur ka patur fëmijë. |
| Bashkia Tepelenë | Mbështetje me paketë ekonomike për të gjitha familjet dhe personat e dhunuar. | Njësoj |
| Bashkia Tropojë | Shërbime psiko-sociale, pako ushqimore, veshmbathje etj | Njësoj |
| Bashkia Mallakastër | Mbështetje me ndihma ushqimore, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet dhe personat e dhunuar. | Mbështetje me ndihma ushqimore. |
| Bashkia Memaliaj | Mbështetje me ndihma ushqimore, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet dhe personat e dhunuar. | Njësoj |
| Bashkia Përmet | Kontakt i vazhdueshëm me banorët, derë më derë, për evidentimin e personave në nevojë, veçanërisht të grave kryefamiljare, për ofrimin e shërbimeve jetësore. | Njësoj |
| Bashkia Librazhd | Informimin e të mbijetuarave për shërbimet që jep institucioni. | Shoqërimi në qendrat e duhura. |
| Bashkia Shkodër | Mbështetje psikologjike, ndihmë ekonomike, informim, këshillim, orientim, shërbime komunitare, shërbime për fëmijët e të mbijetuarave të dhunës. | Identifikimi dhe dhënia e ndihmës psikologjike. |
| Bashkia Delvinë | Mbështetje me ndihma ushqimore, nga UNDP, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet dhe personat e dhunuar, nga paketa e ndihmës ekonomike e bashkisë. | Mbështetje me ndihma ushqimore, nga UNDP, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet dhe personat e dhunuar, nga paketa e ndihmës ekonomike e bashkisë. |

| BASHKIA | SHËRBIM SOCIAL NË NIVEL BASHKIE | SHËRBIM SOCIAL NË NIVEL NJËSIE ADMINISTRATIVE |
|---|---|---|
| **Bashkia Lushnjë** | Identifikim, menaxhim , mbështetje, trajnim , referim dhe monitorim. Shërbime emergjente dhe strehim. Këshillim psikologjik dhe ligjor falas, paketa ushqimore. | Mbështetje, menaxhim, asistim, trajnim dhe monitorim. |
| **Bashkia Këlcyrë** | Mbështetje me ndihma ushqimore, për personin e dhunuar, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet në nevojë. | Paketë ekonomike për të gjitha familjet në nevojë. |
| **Bashkia Finiq** | Mbështetje me ndihma ushqimore, si edhe paketë ekonomike për të gjitha familjet në nevojë dhe personat e dhunuar. Në një rast ju ofrua strehim i përkohshëm të mbijetuarës së dhunës (ambjent nën administrimin e Bashkisë), si edhe paketë ekonomike për të dy personat e dhunuar. Të mbijetuarës tjetër ju ofrua një vend pune. Gjithashtu dhunuesit, pas përfundimit të dënimit 6 mujor, ju ofrua suport për trajtim ndaj varësisë së alkoolit, pasi ishte shkaku i problemit familjar. | Mbështetje me ndihma ushqimore. |
| **Bashkia Kavajë** | Identifikim, menaxhim, mbështetje, asistim, trajtim, referim, monitorim, ndërgjegjësim, shërbime emergjente, këshillim psikologjik dhe ligjor. | Menaxhim, mbështetje, trajtim dhe monitorim. |
| **Bashkia Bulqizë** | Vizita në banesë, paketa ushqimore, ndihmë psikologjike, ndihmë ekonomike, shoqërim i të mbijetuarave në polici, gjykatë dhe qendra shëndetësore. | Referim rastesh, menaxhim rastesh, vizitë në banesë si edhe lidhja e ndihmës ekonomike. |
| **Bashkia Dibër** | Paketa ushqimore dhe psikologjike. | Ndihmë ekonomike. |
| **Bashkia Kukës** | Mbështetje psikologjike, këshillime, ndihmë ekonomike. | Nuk ka |
| **Bashkia Lezhë** | Informim, koordinim, shërbime, shoqërim në gjykatë dhe komisariat, strehim në strehëz, shërbim psikologjik dhe ligjor falas, punësim, asistim. | Aplikim për pagesën e UM, informim, monitorim, asistim. |
| **Bashkia Gjirokastër** | Është shtuar gama dhe përmirësuar cilësia e shërbimeve të ofruar nga Bashkia Gjirokastër përgjatë 2021. Çdo rast suportohet me këshillim psikologjik, juridik, paketa ushqimore-sanitare, veshmbathje, etj. Kur vlerësohet nga MKR, viktima akomodohet pranë Qendrës ku suportohet me shërbimet përkatëse. Rasti trajtohet derisa të vlerësohet që nuk ka më rrezik dhe të cilësohet rast i mbyllur. | Aktivitete ndërgjegjësuese. |

| | | |
|---|---|---|
| **Bashkia Elbasan** | Identifikim, menaxhim, mbështetje, asistim, trajtim dhe referim. | Mbështetje, menaxhim, asistim dhe monitirim. |
| **Bashkia Mirditë** | Menaxhim, këshillim psikologjik e ligjor. | Menaxhim rasti. |
| **Bashkia Peqin** | Plotësohen UM, monitorohen rastet, ofrohet shërbim psiko-social. | Nuk ka |
| **Bashkia Cërrik** | Identifikimi i grupeve në nevojë, mbështetje psiko sociale, këshillim nepërmjet telefonit, informim dhe ndërgjegjësim, mbështetje me paketa ushqimore dhe higjeno sanitare. | Koordinimi i punës me administratorët socialë për identifikim, referimin dhe mbështetjen e target grupeve në nevojë. |
| **Bashkia Kurbin** | Menaxhim të rasteve të dhunës në familje si strehim, bonus qeraje, këshillim psikologjik dhe monitorim. | Nuk ka |
| **Bashkia Belsh** | Identifikim i rasteve, aplikim për UM, ndjekja, adresimi dhe monitorimi i rasteve nga koordinatorja. | Identifikimin dhe referimin i rasteve, aplikimi në sistem të rasteve me UM. |
| **Bashkia Skrapar** | Takimi me grupet ndërsektoriale, ndjekja e urdhrave të mbrojtjes, realizimi i fushtave ndërgjegjësuese për komunitetin, sensibilizimi i qytetarëve dhe njohja e tyre me zyrën vendore të koordinatorit të dhunës, etj. Kemi organizuar takime grupesh ndërsektoriale 3 takime në muaj si edhe takime sensibiluzuese në qytet ku janë ndarë fletëpalosje. | Identifikimi i rasteve dhe raportimi i tyre te koordinatorja vendore e dhunës në familje. |
| **Bashkia Konispol** | Këshillim psikologjik, pako ushqimore, vlerësim risku, shoqërim drejt strehëzës emergjente dhe shërbimeve të tjera. | Aplikim për paketa ushqimore, asistim dhe ndjekje e fëmijëve të viktimave në shkollë si dhe asistencë në qendrën shëndetësore në raste nevoje. |
| **Bashkia Maliq** | Bashkëpunim dhe Koordinim për menaxhimin e situatave. | Raportim dhe ndjekje me koordinatoren lokale. |
| **Bashkia Korçë** | Menaxhim rasti, mbështetje ligjore, vleresim i riskut në bashkëpunim me policinë. Ndihma me pako ushqimore. | Mbështetje ligjore, shpërndarje fletëpalosjeje me numër e policisë dhe numër fiks pa pagesë 0800 34 34 |
| **Bashkia Shijak** | Paketa ushqimore, ndihma ekonomike, vizita në familje, këshillim psikologjik. | Paketa ushqimore, lidhje të ndihmës ekonomike, trajtim i rastit në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve sociale. |

| | | |
|---|---|---|
| **Bashkia Pogradec** | Ndihmë ekonomike për viktimat e dhunës në familje, menaxhimi i rasteve dhe monitorim. | Ndihmë ekonomike për viktimat e dhunës në familje dhe monitorimi i rasteve të dhunës. |
| **Bashkia Malësi e Madhe** | Adresim tek organet e policisë shtetit. | Është menaxhuar vetëm një rast së bashku me shërbimet sociale. |
| **Bashkia Dropull** | Shpërndarje e paketës ushqimore te familjet e të moshuareve. | Nuk ka |
| **Bashkia Vlorë** | Këshilllim psikosocial, ndërmjetësim dhe koordinim me shërbimet e tjera të MKR, advokim dhe lobim gjatë fushatës se 16 ditëve kundra dhunës me bazë gjinore, orientim dhe mbështetje për aplikim ndihme ekonomime në baze te UM, monitorime të rasteve. | Monitorim të rasteve me UM si dhe orientim dhe mbështetje për të aplikuar për ndihmë ekonomike. |
| **Bashkia Sarandë** | Shërbimet sociale në nivel bashkie japin orientim dhe mbështetje për aplikim ndihme ekonomime në bazë të UM, ndërmjetësim dhe koordinim me shërbimet e tjera të MKR. Advokim dhe lobim gjatë fushatës së 16 ditëve kundra dhunës me bazë gjinore, monitorime të rasteve. | Shërbimet sociale në nivel Njësie Administrative realizojnë monitorim të rasteve dhe ofrojnë mbështetje për përfitimin e ndihmës ekonomike si të mbijetuara të dhunës. |
| **Bashkia Himarë** | Shërbimet sociale në nivel bashkie mundësojnë asistim me shërbime emergjente si pako ushqimore dhe pagesën e UMM/UM. | Shërbimet sociale në nivel Njësie Administrative<br>pagesën e UMM/UM. |
| **Bashkia Selenicë** | Këshilllim psikosocial, ndërmjetësim dhe koordinim me shërbimet e tjera të MKR, advokim dhe lobim gjatë fushatës se 16 diteve kundra dhunës me bazë gjinore, orientim dhe mbështetje për aplikim ndihme ekonomime në baze te UM, monitorime të rasteve. | Monitorim të rasteve me UM si dhe orientim/mbështetje për të aplikuar për ndihmë ekonomike. |
| **Bashkia Fier** | Plotësimi i vlerësimit të riskut të të mbijetuarave në Komisariat, janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme të mbijetuarat e dhunës. Është marrë pjesë në proceset gjyqësore dhe janë monitoruar sipas afateve UM. | Mirëmenaxhim i rasteve të dhunës. Ofrimi i paketave<br>ushqimore si dhe janë ndihmuar të mbijetuarat për aplikimin për UM. |
| **Bashkia Patos** | Vlerësim i riskut, vlerësimi i nevojave të rasteve, mbështetje psikologjike dhe ligjore, transport i sigurt, paketa ushqimore, strehim afatgjatë. | Nuk aplikohet |
| **Bashkia Pukë** | Përgatitje e planit individual të të mbijetuarës, mbështetje<br>financiare, shoqërim i të mbijetuarës në bashkëpunim me OJF në strehëza. | Referim rasti. |
| **Bashkia Ura Vajgurore** | Mbështetje ekonomike, psikologjike, ligjore. | Mundësimi i ndihmës ekonomike. |

| | | |
|---|---|---|
| **Bashkia Fushë Arrëz** | Pako ushqimore, ndihmë ekonomike, këshillim psikologjik. | Pako ushqimore, ndihmë ekonomike, këshillim psikologjik. |
| **Bashkia Krujë** | Mbështetje, monitorim i rastit, ekzekutim i urdhërit të mbrojtjes, hartim i planit individual. | Ndjekje, monitorim dhe menaxhim i rastit. |
| **Bashkia Berat** | Përfshirja e të mbijetuarave të dhunës në familje në ndihmë ekonomike. Strehim emergjent për të gjitha rastet me nivel risku të moderuar dhe të lartë në Strehëzën e Emergjencave si edhe mbështetje me strehim afatgjatë nëpërmjet përfshirjes në projekte të cilat zbatohen në bashkinë Berat si dhe ofrimin e banesave sociale. Mbështetje me paketa ushqimore dhe higjeno-sanitare. Ndërmjetësim për punësim. Mbështetje psikologjike. Organizim takimesh dhe aktivitetesh për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinor. | Përfshirja në ndihmë ekonomike e rasteve të dhunës në familje. Referime rastesh tek Koordinatorja në bashki. |
| **Bashkia Poliçan** | Asistim në raste, monitorim i rastit si dhe mbështetje me shërbimet e sipër përmendura. | Monitorim i rastit. |
| **Bashkia Klos** | Këshillim, mbështetje financiare. | Vlerësim social-ekonomik dhe pagesën e UM. |
| **Bashkia Kuçovë** | Ndihmë sociale. | Informim. |
| **Bashkia Rrogozhinë** | Menaxhim i rasteve dhe bashkepunim me institucionet lokale, diskutim i rastit në ETN, mbështetje me programet sociale të bashkisë, lehtësim të proçedurave për kopshtet e fëmijeve. | Asistim nga punonjësi social për menaxhim rasti. |
| **Bashkia Tiranë** | Strehim social (bonus qiraje, mbulim qiraje 2-3 muaj nga organizata bashkëpunëtore). | Nuk ka |
| **Bashkia Divjakë** | Ndihma me punësim ose asistencë sociale. | Menaxhim rasti. |
| **Bashkia Pustec** | Mbështetje me paketa ushqimore. | Nuk ka |

| | | |
|---|---|---|
| **Bashkia Kamëz** | Shërbimet sociale në bashki ofrojnë asistimin e rastit gjatë plotësimit të UM në ambientet e komisariatit, shoqërimin e të mbijetuarave pranë QSH për të marrë shërbimin e duhur mjekësor, shoqërimin e të mbijetuarave pranë gjykatës, ofrimin e bonusit të qerasë, mbështetje me pako ushqimore, mbështetje për punësim, vizita në familje për identifikimin e nevojave. | Në nivel Njësie Administrative ndiqen të njëjtat procedura dhe ofrohen të njëjtat shërbime si në nivel bashkie. |
| **Bashkia Prrenjas** | Shërbimet ndiqen nga KDH. | Referojnë rastet e dhunës. |
| **Bashkia Roskovec** | Akordim të ndihmës ekonomike, monitorim i UM, mbështetje psiko-sociale, aktivitete ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese. | Mundësojnë koordinimin e aktorëve. |
| **Bashkia Vau i Dejës** | Transport, kujdes shëndetësor, mbështetje psikologjike, këshillim ligjor, shërbime, punësim, mbështetje me asistencë sociale, pako ushqimore. | Mundësojnë referimin e rasteve. |
| **Bashkia Durrës** | Bashkia Durrës ofron mbështetje nëpërmjet asistencës juridike, mbështetje në aspektin social dhe psikologjik, është vendosur në dispozicion linja telefonike pa pagesë si dhe ofrohet ndihmë për aplikimin për përfitimin nga ndihma ekonomike. | Aplikim në skemën e NE. Mbështetje me informacion. |
| **Bashkia Mat** | Identifikim, vlerësim, menaxhim, ndjekje dhe monitorim të rasteve. | Nga ana e njësisë administrative janë marrë masat për identifikimin dhe referimin e rasteve. |
| **Bashkia Gramsh** | Nuk ka | Nuk ka |
| **Bashkia Devoll** | Shërbimi Social në bashkinë e Devollit ofron ndihmë psikologjike, asiston të mbijetuarat e dhunës në aspektin e kujdesit shëndetësor, menaxhon rastet si dhe pajis me ushqime dhe veshmbathje të mbijetuarat në kushte emergjence. | Pagesa në PAK, monitorim rastesh, idetifikim nevojash, shërbime shëndetesore, kujdes shëndetësor, shërbime arsimore, identifikime të rasteve në shkolla, mbështetje psikologjike dhe aktivitete ndërgjegjësuese. |
| **Bashkia Kolonjë** | Ofrimi i paketës së shërbimeve mbështetëse, monitorim i masave të marra të mbrojtjes. | Monitorim i rastit, ofrim i ndihmës ekonomike. |
| **Bashkia Vorë** | Kërkohet rritje e bashkëpunimit nga të dyja njësitë e qeverisjes vendore. | |

*Referuar Parimit të Subsidiaritetit kryerja e funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, është një nga parimet thelbësore të eficencës dhe funksionimit të shtetit. Modelet e mira të Bashkisë Berat dhe Korçë për fushtata sensbilizuese në lidhje me legjislacionin dhe të drejtat e grave duhet të arrihet dhe nga bashkitë e tjera.*

## 2.3 SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Shërbimi shëndetësor është një nga shërbimet thelbësore të cilat përfshijnë një sërë shërbimesh bazë që ofrohen nga sektori i shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, policisë dhe drejtësisë. Shërbimet duhet minimalisht të garantojnë të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e secilës grua ose vajze që ka përjetuar ose përjeton dhunë me bazë gjinore.

Sugjerohet që trajnimi të jetë pjesë e një programi/kurrikule gjithëpërfshirëse, që të përmbajë, gjithashtu, edhe sesione mbi reagimin shumësektorial kundër DHF-së/DHBGJ-së, parimet bazë të ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së, të cilat duhet të reflektohen në shërbimet shëndetësore që ofrohen për këto raste, sesione mbi parandalimin dhe ndërgjegjësimin, etj. Duke qenë se punonjësit e shërbimit të kujdesit shëndetësor, janë parë si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) si dhe pjesë të Ekipt Teknik Disiplinor të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor puna e mirë e tyre do të shërbejë në fuqizimin e vazhdueshëm të MKR. Gratë dhe vajzat shpesh kërkojnë shërbime shëndetësore për dëmtimet e tyre edhe nëse nuk e tregojnë dhunën apo abuzimin e lidhur me këto dëmtime.

### 28 ORGANIZATA TË CILAT OPEROJNË NË BASHKITË E VENDIT MENDOJNË SE SHËRBIMI SOCIAL NË NIVEL BASHKIE DUHET TË PËRMIRËSOHET

| | |
|---|---|
| **BASHKIA HAS** | Shërbimet shëndetesore për rastet e dhunës në familje kanë qenë mjekim nëse rasti ka qenë i rëndë, si dhe bashkëpunim me KVDHF për rastet me çrregullime psikologjike për t'i transportuar në institucionet përkatëse. Ndihmesë me medikamente është ofruar dhe nga ana e organizatave që operojnë në këtë bashki. |
| **BASHKIA TEPELENË** | Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Bashkia e Tepelenës janë: shoqërim për ndihmë mjekësore, si edhe trajtimin e të dhunuarit/ës për shëndetin mendor, me psikologun e vendosur nga Bashkia, që është psikolog i Zyrës arsimore lokale. |
| **BASHKIA TROPOJË** | Shërbimet shëndetësore: medikamente dhe raporte mjeksore. |
| **BASHKIA LIBRAZHD** | Shërbimet shëndetësore: Kujdes shëndetësor i menjëhershem dhe konfidencial. |
| **BASHKIA DELVINË** | Shërbimet shëndetësore të ofruara janë: shoqërim për ndihmë mjekësore, në qendrën shëndetësore DL, si edhe trajtimin e të dhunuarit/ës për shëndetin mendor, me psikologun e shoqatës Jona. |
| **BASHKIA KËLCYRË** | Shërbimet shëndetësore të ofruara janë: shoqërim për ndihmë mjekësore, në qendrën shëndetësore Këlcyrë. |
| **BASHKIA FINIQ** | Shërbimet shëndetësore të ofruara: trajtimi i të dhunuarave për shëndetin mendor, me psikologun e vendosur nga Bashkia. |
| **BASHKIA DIBËR** | Shërbimet shëndetësore: Vizita dhe mjekime. |
| **BASHKIA KUKËS** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |

| | |
|---|---|
| **BASHKIA LEZHË** | Shërbimet shëndetësore: Ndihmë psikologjike dhe shëndetësore. |
| **BASHKIA GJIROKASTËR** | Shërbimet shëndetsore: Referim rastesh dhe bashkëpunim. |
| **BASHKIA PEQIN** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA KURBIN** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA SKRAPAR** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA MALIQ** | Shërbimet shëndetësore: Dhënia e ndihmës të parë dhe raportim i rasteve. |
| **BASHKIA TIRANË** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA KONISPOL** | Shërbimet shëndetësore: Vleresimi mjeko-ligjor, kontrolli i përgjithshëm i të mbijetuarës, kur ka qenë e nevojshme. Gjithashtu është ofruar edhe trajtim psikologjik nga ana e shoqatave të ndryshme. |
| **BASHKIA BELSH** | Shërbimet shëndetësore: Referim dhe mbështetje për rastet me (çrregullime psikologjike). |
| **BASHKIA CËRRIK** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA MIRDITË** | Kujdes shëndetësor, ekspertizë. |
| **BASHKIA BULQIZË** | Shërbimet shëndetësore: Dhënia e ndihmës së parë në bashkëpunim dhe me policinë e shtetit. |
| **BASHKIA GJIROKASTËR** | Shërbimet shëndetësore: Dhënia e ndihmës së parë në bashkëpunim dhe me policinë e shtetit. |
| **BASHKIA MEMALIAJ** | Shërbimet shëndetësore: Shoqërim për ndihmë mjekësore, në spitalin zonal. |
| **BASHKIA PËRMET** | Shërbimet shëndetësore: Shoqërim i nga punonjësit socialë të bashkisë, kur është nevojitur ndihma mjekësore. |
| **BASHKIA SHKODËR** | Shërbimet shëndetësore: Ofrimi i medikamenteve të rekomanduara nga mjeku individit në nevojë. Gjithashtu në Bashkinë Shkodër janë ofruar edhe trajtime psikologjike nga ana e shoqatave. |
| **BASHKIA LUSHNJE** | Shërbimet shëndetësore: Përkrahje, përkujdesje shëndetesore, identifikim dhe referim. |
| **BASHKIA KAVAJË** | Shërbimet shëndetësore: Përkrahje, përkujdesje shëndetësore, identifikim, referim. |
| **BASHKIA ELBASAN** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |

| | |
|---|---|
| **BASHKIA SHIJAK** | Shërbimet shëndetësore: Vizita mjekësore falas. Në këtë bashki është ofruar nga ana e organizatave dhe këshillimi psikologjik për të mbijetuarat e dhunës. |
| **BASHKIA MALËSI E MADHE** | Shërbimet shëndetësore: Nuk ka patur raportime për vitin 2021. |
| **BASHKIA VLORË** | Shërbimet shëndetësore: Të gjitha shërbimet mjekësore të nevojshme për të mbijetuarat e dhunës, si dhe ekspertiza mjekoligjore sipas rastit. Në Bashkinë e Vlorës mbështetja psikologjike për të mbijetuarat e dhunës është realizuar nga shoqatat. |
| **BASHKIA DIVJAKË** | Shërbimi shëndetësor: Vizita periodike për gratë dhe fëmijët. |
| **BASHKIA HIMARË** | Shërbimet shëndetësore: Ndihmën mjekësore parësore. |
| **BASHKIA FIER** | Shërbimet shëndetësore: U janë ofruar të mbijetuarave të dhunës si në ambientet e spitalit ashtu edhe ne banesat e tyre, në rastet kur kanë pasur nevoja shëndetësore. |
| **BASHKIA URA VAJGURORE** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA FUSHË ARRËZ** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA PUSTEC** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA BERAT** | Shërbimet shëndetësore: Referiminet e rasteve të dhunës në familje tek KDHF bashki. |
| **BASHKIA KLOS** | Shërbimet shëndetësore: Nuk ka patur raste për ndihmë shëndetësore. |
| **BASHKIA KRUJË** | Shërbimet shëndetësore: Kujdes shëndetësor i menjëhershëm dhe konfidencial. |
| **BASHKIA PUKË** | Raportim i rastit, vizita të të mbijetuarës tek mjeku. |
| **BASHKIA PATOS** | Shërbimet shëndetësore: Kujdes shëndetësor. |
| **BASHKIA SELENICË** | Shërbimet shëndetësore: Të gjitha shërbimet mjekësore, ekspertiza mjekoligjore sipas rastit. |
| **BASHKIA RROGOZHINË** | Shërbimet shëndetësore: Ndihmë mjekësore dhe ndërhyrje për ndihmën e parë. |
| **BASHKIA SARANDË** | Shërbimet shëndetësore: Japin të gjitha shërbimet mjekësore përkatese si dhe është ofruar shërbim psikologjik nga "Shoqata Jona". |
| **BASHKIA POGRADEC** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA KORÇË** | Shërbimet shëndetësore: Ekzaminim nga mjeku ligjor, pajisje e të mbijetuarës me raportin përkatës. |
| **BASHKIA DROPULL** | Shërbimet shëndetësore: Shpërndarje e medikamenteve te të moshuarit. |

| | |
|---|---|
| **BASHKIA POLIÇAN** | Shërbimet shëndetësore: Shpërndarje e medikamenteve te të moshuarit. |
| **BASHKIA KUÇOVË** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA KAMËZ** | Shërbime shëndetësore: Bashkia ofron shërbime shëndetësore, përgatisin raportin mjekësor, që është i nevojshëm gjatë seancave gjyqësore për përfitimin e UM, vizita mjekësore, vizita mjeko-ligjore. |
| **BASHKIA PRRENJAS** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA RROSKOVEC** | Kujdes shëndetësor shoqërimi për në qendër shëndetësore. |
| **BASHKIA VAU I DEJËS** | Kujdes shëndetësor për të mbijetuarat e dhunës. |
| **BASHKIA DURRËS** | Asistencë për të mbijetuarat e dhunës nëpërmjet mjekëve të familjes. |
| **BASHKIA MAT** | Identifikim i rasteve dhe ofrimi i shërbimit shëndetësor. |
| **BASHKIA GRAMSH** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA LIBOHOVË** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |
| **BASHKIA DEVOLL** | Ofrohet kujdes shëndetësor. |
| **BASHKIA VORË** | Rekomandon rritje të cilësisë së shërbimit shëndetësor. |
| **BASHKIA KOLONJË** | Në pyetësorin e plotësuar, Bashkia shprehet se gjatë vitit 2021 nuk ka ofruar shërbim shëndetësor për të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së. |

*Nga të dhënat e raportuara nga Bashkitë rezulton se në 10 Bashki të vendit nuk ofrohet shërbim shëndetësor ndër to renditet dhe Bashkia e Elbasanit dhe Tiranës të cilat raportojnë raste të larta raportimi të dhunës në familje. Bashkitë e tjera e ofrojnë shërbimin shëndetësor duke raportuar për një bashkëpunim të mirë me qendrat shëndetësore dhe organet përgjegjëse për trajtimin e gjendjes së tyre fizike dhe psikologjike. Asistenca psikologjike është realizuar kryesisht nga shoqatat që veprojnë në territorin e bashkive.*

## 2.4. PROKURORIA DHE GJYKATA

## ROLI I PROKURORISË DHE GJYKATËS

Një nga detyrat më të rëndësishme dhe sensitive që kanë bashkitë në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është edhe shoqërimi i të mbijetuarit/ës të/së dhunës në polici, gjykatë, ose institucionet e tjera gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. Koordinatori Vendor kundër Dhunës në familje është edhe personi përgjegjës për kryerjen e këtij shoqërimi. Kur rasti është vlerësuar me një rrezik të lartë ose të mesëm, i mbijetuari/a i/e dhunës me bazë gjinore dhe i/e dhunës në familje shoqërohet për në institucionet e lartpërmendura nga policia dhe koordinatorja vendore kundër dhunës në familje dhe/ose punonjësja e mbrojtjes së fëmijëve.

Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare njofton stafin e strehëzës emergjente, me qëllim sigurimin e jetës të të mbijetuarës të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.

Referuar Protokollit të Menaxhimit të rasteve të Dhunës në Familje  në nivel vendor, përmes MKR, prokurori për rastet që kërkojnë ndërhyerje emergjente ka këto detyra:
1. Ushtron ndjekjen penale kur është përpara veprave të dhunës në familje dhe/ose shkeljes së UMM;
2. Ndihmon viktimën/at me informacionin e nevojshëm në lidhje me prezantimine akuzave penale për dhunën në familje, mënyrën e depozitimit të akuzave penale, dokumentacionin që nevojitet, si dhe për veprimet që duhet të kryejnë në vijim përmes koordinatores mbi të drejtat e viktimave në këtë institucion; Koordinatorja mbi të drejat e viktimave në këtë institucion asiston viktimat nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe printuar.
3. Mund të paraqesë në gjykatën e rrethit gjyqësor kërkesë për UM dhe UMM për viktima të rritur dhe të mitur.

Detyrat e Gjykatës janë:
1. Vlerëson UMPMM e lëshuar nga struktura e Policisë së Shtetit;
2. Lëshon UMM për viktimën/at e dhunës në familje;
3. Disponon informacion të përditësuar për qendrat rezidenciale që ofrojnë akomodim për viktimat e dhunës në familje dhe/ose fëmijët e tyre, si dhe për shërbimin e këshillimit të burrave dhe djemve, për referimin aty të dhunuesve;
4. 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos: a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhërin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes; b) anulimin e urdhërit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.
5. Gjykata, për nevoja të gjykimit, thërret përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose KVDHF për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime;
6. Garanton sigurinë në gjykatë, mos cenimin fizik apo verbal të viktimës në ambientet e gjykatës gjatë proceseve për çështjet me objekt vlerësimin e UMPMM, lëshimit të UMM dhe vërtetimit të UMM.
7. Parashikon masa mbrojtëse kryesisht, në urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes për fëmijët të cilët kanë pësuar dhunë ose kanë asistuar në skena dhune;
8. Mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:
1. Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
2. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.
3. Përgjegjësitë e gjykatave sipas Ligjit për Dhunën në Familje lidhen me shqyrtimin e kërkesave për UM / UMM-të. Në nenin 10 të Ligjit përcaktohen të gjitha detyrat që gjykata ka në rastin e dhunës në familje. Një nga objektet kryesore të ligjit është edhe fuqizimi i sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje, si një nga elementët më të rëndësishëm kundër dhunës në familje.
Bashkëpunimi i bashkive për vitin 2021 me Prokurorinë dhe Gjykatën paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| BASHKIA | PROKURORIA | GJYQËSORI |
| --- | --- | --- |
| **BASHKIA HAS** | Shërbimet përkatese për rastet e dhunës në familje dhe për rastet kur janë të përfshire fëmijet. | Pranimin e kërkes padive për UMM dhe lëshimin e UM. |
| **BASHKIA TEPELENË** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta. | Urdhër mbrojtjeje të menjëhershme, për viktimat me një procedure të shpejtë, pa pagesë. |
| **BASHKIA TROPOJË** | — | Paisje me UM dhe UMM. |
| **BASHKIA MALLAKASTËR** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta. | UM të menjëhershme, për të 3 të mbijetuarat përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë dhe pa pasur nevojë për ndihmën e një avokati. |
| **BASHKIA MEMALIAJ** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta. | UM, për të mbijetuarat e dhunës përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë. |
| **BASHKIA PËRMET** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta, kur është nevojitur. | Mbështetje të menjëhershme, përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë dhe pa pasur nevojë për ndihmën e një avokati, kur është nevojitur. |
| **BASHKIA LIBRAZHD** | Sigurimi i një analize të çështjeve ligjore të paraqitura. | Ofrimin e shërbimit gjygjësor korrekt të palëve dhe marrjen e vendimit për urdhër mbrojtje. |
| **BASHKIA SHKODËR** | Dhënie informacioni për gjendjen reale të grave me UM. | Asistencë në seancat gjyqësore, përgatitjen e raporteve të vleresimit të gjendjes social ekonomike. |
| **BASHKIA DELVINË** | Mbështetje për veprimet ligjore nga juristi i bashkisë dhe ndjekja e çështjes. | Viktimat kanë marrë UM, me një procedurë të shpejtë, pa pagesë me mbështetje nga juristi i bashkisë. |
| **BASHKIA LUSHNJË** | Siguri dhe referim. | Vlerësim, siguri, referim dhe vendim. |
| **BASHKIA KËLCYRË** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta. | UM të menjëhershme, për të mbijetuarat, përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë. |

| BASHKIA | PROKURORIA | GJYQËSORI |
| --- | --- | --- |
| **BASHKIA FINIQ** | Mbështetje për veprime ligjore të shpejta dhe të thjeshta. | UM të menjëhershme, për të 2 viktimat përmes një procedure të shpejtë, pa pagesë dhe pa pasur nevojë për ndihmën e një avokati. |
| **BASHKIA KAVAJË** | Siguri dhe referim. | Siguri dhe referim. |
| **BASHKIA BULQIZË** | — | Shqyrtimi i kërkesave në UNM/UM. |
| **BASHKIA DIBËR** | — | — |
| **BASHKIA KUKËS** | — | Lëshim të  UMM dhe UM. |
| **BASHKIA LEZHË** | Ndihmë ligjore infomrim. | Ndihmë ligjore, informim. |
| **BASHKIA GJIROKASTËR** | Bashkëpunim. | Bashkëpunim. |
| **BASHKIA ELBASAN** | Siguri, referim. | Siguri, referim. |
| **BASHKIA MIRDITË** | Ndjekje penale. | Lëshim të UMM, UM. |
| **BASHKIA PEQIN** | — | — |
| **BASHKIA CËRRIK** | — | — |
| **BASHKIA KURBIN** | — | — |
| **BASHKIA BELSH** | — | Lëshimin e UM. |
| **BASHKIA SKRAPAR** | — | — |
| **BASHKIA KONISPOL** | Referim i rasteve menjëherë pranë shërbimit social. | Dhënie e vendimeve për UMM/UM dhe masat kundër dhunës. |
| **BASHKIA FINIQ** | Vënie në dijeni të rasteve të paraqitura institucionin. | — |
| **BASHKIA KORÇË** | Ushtron ndjekjen penale kur është përpara veprave të dhunës në familje dhe/ose shkeljes së UM, ofron mbështetje ligjore nga kordinatorja mbi të drejtat e të mbijetuarave në këtë institucion. | Lëshon UM, UMM për të mbijetuarat e dhunës në familje. |

| BASHKIA | PROKURORIA | GJYQËSORI |
| --- | --- | --- |
| **BASHKIA SHIJAK** | — | Lëshim i UM , Këshillim ligjor. |
| **BASHKIA POGRADEC** | — | — |
| **BASHKIA MALËSI E MADHE** | — | — |
| **BASHKIA DROPULL** | — | — |
| **BASHKIA VLORË** | Hetim i rastit për vepër penale të dhunës në familje, bashkëpunim me shërbimin social sipas rastit. | Shërbimet e gjygjësorit – pasjisje e të mbijetuarës me UMM dhe UM me afate kohore deri në një vit. |
| **BASHKIA SARANDË** | Prokuroria bën hetimet e nevojshme dhe ka një koordinator që mbështet rastet e dhunës në familje. | Shërbimet e gjygjësorit – pajisja e të mbijetuarave me UM ose UMM. |
| **BASHKIA HIMARË** | Prokuroria trajtimin e rasteve që kallëzohen në komisariat. | Shërbimet e gjygjësorit ofrimin ose refuzimin e kërkesave për UMM/UM. |
| **BASHKIA SELENICË** | Hetim i rastit për vepër penale të dhunës në familje, bashkëpunim me shërbimin social sipas rastit. | Pasjisje e të mbijetuarës me UMM dhe UM me afate kohor deri në një vit. |
| **BASHKIA FIER** | Janë proceduar penalisht rastet që kanë pasur ndjekje penale. | Janë zhvilluar rregullisht seancat gjyqësore për lëshimin e UMM dhe UM, si dhe është bërë shpërndarja e tyre nga gjykata. |
| **BASHKIA PATOS** | — | Lëshimin e UMM/UM |
| **BASHKIA PUKË** | — | Shërbime juridike, lëshim i UM |
| **BASHKIA URA VAJGURORE** | Kyerje hetimesh | Vendimet sipas ligjit në varësi të situatës |
| **BASHKIA FUSHË ARRËZ** | — | — |
| **BASHKIA KRUJË** | Siguri e të mbijetuarave, gatishmëri në kryerjen e procedurave të përshpejtuara. | Caktim i gjyqeve, vendim i menjëhershëm për UM. |
| **BASHKIA BERAT** | Nuk kemi të dhëna | Shërbim parësor falas. |
| **BASHKIA POLIÇAN** | S'ka përgjigje | S'ka përgjigje |

| BASHKIA | PROKURORIA | GJYQËSORI |
|---|---|---|
| **BASHKIA KLOS** | Hetimin e çështjeve dhe dërgimi në gjykatë për dhënien e vendimeve të nevojshme. | Lëshimin e urdhërave të mbrojtjes |
| **BASHKIA KUÇOVË** | — | Divorcet për çiftet dhe fëmijët. |
| **BASHKIA RROGOZHINË** | Zgjidhje e çështjes për 24 orë. Bashkëpunim me policinë. | Sigurim i UM, |
| **BASHKIA TIRANË** | — | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 1 janar 2021 deri në datë 31 dhjetor 2021, raporton të përfunduara gjithsej 146 çështje me objekt "Urdhër Mbrojtje", nga të cilat: – 66 janë pranuar dhe – 80 pushuar/rrëzuar. Si dhe janë përfunduar 836 me objekt "Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje", nga të cilat: – 435 janë pranuara dhe – 401 janë pushuar/rrëzuar. |
| **BASHKIA DIVJAKË** | Po ashtu ka përshpejtuar procesin e për rastet në shqyrtim. | Ka përshpejtuar procesin gjyqësor kur ka qenë mundësia por dhe vendimet që janë marrë kanë qenë të drejta. |
| **BASHKIA PUSTEC** | — | — |
| **BASHKIA KAMËZ** | Shërbimi i dhënë nga prokuroria konsiston në vlerësimin e rasteve të dhunës në familje përfshirë shkeljen e urdhërave të mbrojtjes. | Konfirmimin e UMM/UM për të mbijetuarat e dhunës në familje, përshpjetimin e lëshimit të urdhërave të mbrojtjes, trajtimi me prioritet i të mbijetuarave të dhunës në familje. |
| **BASHKIA PRRENJAS** | Ofrohen shërbime dhe ka bashkëpunim të mirë. | Bashkëpunim të mirë. |
| **BASHKIA ROSKOVEC** | Prokuroria ka qenë përgjegjëse për menaxhimin e mirë të rasteve. | Gjatë vitit 2021 është bërë rakordimi i UM dhe UMM. |
| **BASHKIA VAU I DEJËS** | Nuk është ofruar asnjë shërbim | Janë dhënë UM |

| BASHKIA | PROKURORIA | GJYQËSORI |
| --- | --- | --- |
| **BASHKIA KOLONJË** | Prokuroria ka ndjekur dhunuesit që kanë kryer vepra të rënda të dhunës dhe që shkelin UM. | Lëshimi i UMM dhe UM. |
| **BASHKIA VORË** | Bashkëpunim me policinë dhe gjyqësorin. | Bashkëpunim me prokurorinë dhe policinë. |
| **BASHKIA DEVOLL** | Bashkëpunim për menaxhimin e rasteve. | Vendimmarrje për masat e dhunës. |
| **BASHKIA MAT** | Referim dhe identifikim i rasteve. | Pajisja me UMM dhe UM. |
| **BASHKIA DURRËS** | Ndjekja e procedurave për sigurimin e UMM. | Këshillim ligjor falas. |

## MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT (MKR) TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR), është një rrjet organizmash i cili krijohet pranë çdo bashkie dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Veprimtaria e tij rregullohet nëpërmjet Ligjit për "Masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), i cili ka parashikuar krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e të mbijetuarave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Ky rol do të ushtrohet nëpërmjet Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje" (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës në familje. Gjithashtu Vendimi Nr. 327, datë 2.06.2021 "Vendim për Mekanizmin e Bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës" paraashikon edhe masat që duhet të merrën nga ky organizëm. Për vetë rëndësinë që paraqet në lidhje me veprimtarinë e tij, shtrirjen dhe funskionimin e MKRV-e, duhet të raportohet edhe në Nënkomisionit "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas", pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Kuvendin e Shqipërisë.

Mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, është parakusht për zhvillimin e një vendi; çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet. Mekanizmat Institucionalë të cilat janë përgjegjës për adresimin e dhunës në familje janë edhe porta e parë ku një i/e dhunuar në familje apo me bazë gjinore drejtohet.

## ORGANIZIMI I MKR ËSHTË SI MË POSHTË:




## KOMITETI DREJTUES

"Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje", të cilat funksionojnë pranë çdo bashkie kryesohet nga kryetari i Bashkisë dhe ka në përbërjen e tij, në secilën bashki:

a) përfaqësuesin e strukturës së Policisë së Shtetit;
b) përfaqësuesin e drejtorisë arsimore;
c) përfaqësuesin e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
ç) drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë;
d) përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark;
dh) përfaqësuesin e prefektit të qarkut;
e) kryetarin e qarkut në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki;
ë) përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit;
f) drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
g) drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit janë këto njësi, si dhe qendrave të rehabilitimit për dhunuesit;
gj) përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
h) drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit dhe përfaqësuesin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike;
i) KV-në, i cili, për rastet kur bashkia ka 2 (dy) të tillë, caktohet nga kryetari i bashkisë.

## EKIPET TEKNIKE NDËRDISIPLINORE

(në vijim ETN), i cili përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues, përbëhet nga përfaqësues teknik/specialistë të institucioneve të përfaqësuara në MKR. Përfaqësues nga prefektura përkatëse, nga Shërbimi i Provës, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të vetëqeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë nga fushat sociale, të psikologjisë, avokatisë, të shërbimit shëndetësor, të mjekësisë ligjore, përmbarimit dhe Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas.

## KOORDINATORI(JA)

Vendor(e) kundër Dhunës në Familje (KVDHF) – Specialist(e) i(e) emëruar me kohë të plotë në Bashki, me detyrimin dhe përgjegjësinë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM nr. 334, datë 17.02.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Veprimtaria e MKR është standartizuar nëpërmjet një protokolli të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, përmes mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR) i cili synon të standardizojë veprimet e nevojshme për t'u kryer nga të gjithë anëtarët e MKR-ve për të siguruar një reagim të menjëhershëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre ligjore, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe vënien e dhunues(e)ve përpara përgjegjësisë. Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 "PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE" (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020), përcakton qartësisht krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve me qëllim mbrojtjen mbështetjen dhe rehabilitimin e të mbijetuarave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
Një Mekanizëm Referues i suksesshem nënkupton raste dhune të trajtuara në moment, të mirëkoordinuara midis institucionesh dhe personi i dhunuar i adresuar në të gjitha aspektet në kohën më të shkurtër të mundshme (mbrojtje gjykate, kujdes shëndetësor, strehim etj.)

Në vijim po pasqyrojmë shkurtimisht bashkëpunimin e bashkive me institucionet përbërëse të MKRS-së në funksion të trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore:

> ***1. Nga raportimet e kryera rezulton se të gjitha bashkitë e kanë funksional MKR-në me përjashtim të Bashkisë Cërrik ku Mekanizmi i Kordinuar i Referimit pavarësisht se është ngritur në vitin 2018, ende nuk është funksional. I vetmi institucion që referon dhe adreson problematikat e të mbijetuarave të dhunës në familje pranë Sektorit Social është Komisariati i Policisë Cërrik i cili ka një bashkëpunim efektiv me bashkinë.***

VE dhe pse MKR-ja është institucionalizuar në të gjitha bashkitë, funksionimi i këtij rrjeti edhe për vitin 2021 ka hasur në disa problematika. Një nga problematikat më evidente, ndër informacionet e përcjella mbetet realizimi i mbledhjeve të **Ekipit Teknik Ndërdisiplinor (ETN),** ku legjislacioni në fuqi **parashikon se ETN ka detyrim të mblidhet në raste të zakonshme çdo muaj dhe në raste të jashtëzakonshme edhe më shpesh.**

Nga ana e MKR nevojitet adresimi i rasteve të ndeshura në praktikë, si dhe për të ndërhyrë më ndjeshëm në parandalim, informim e ndërgjegjësim. Mbledhja e rregullt e të dhënave mbi menaxhimin e rasteve në mënyrë shumë-disiplinare të koordinuar, si dhe pasqyrimi i përditësuar i tyre në sistemin REVALB, do të jetë gjithashtu pjesë e veprimeve për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të MKR në vend. Mbetet një tjetër sfidë në punën për parandalimin e dhunës në familje. Trajnimi online i anëtarëve të MKR-ve për të njohur dhe zbatuar Rekomandimin e Këshillit të Evropës Rec/KM/(2019) për "Parandalimin dhe luftimin e seksizmit". Monitorimi periodik i efektivitetit të funksionimit të MKR në vend dhe i koordinimit efektiv të tyre me mekanizmat e tjerë ekzistues kundër dhunës ndaj fëmijëve apo trafikimit të personave.
Të gjitha rastet që referohen pranë organeve përgjegjëse duhet të trajtohen në mënyrë të menjëhershme, me efektivitet dhe duke u ofruar shërbime shumë-disiplinare.
Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis institucioneve pjesë e MKR-së.

Mbrojtja nga dhuna në familje është një proces afatgjatë, i cili kërkon angazhim afatgjatë, burime dhe koordinim mes autoriteteve të qeverisë qendrore dhe asaj të vetëqeverisjes vendore, OSHC-ve dhe donatorëve. Përvoja e dhjetë viteve të fundit me mbështetjen nga partnerët për zhvillim/komuniteti i donatorëve për ngritjen e MKR-ve në nivel vendor dhe për funksionimin e tyre, përbën provë se sistemit i nevojitet jo vetëm kohë, por edhe burime (njerëzore dhe financiare), vullnet politik, koordinim shumëpalësh dhe monitorim i vazhdueshëm në mënyrë që të funksionojë dhe të jetë efektiv.

Monitorimi i MR, përmes POM, ka nxjerrë në pah nevojën e përmirësimit dhe plotësimit me nene të reja të ligjit "Për masa kundër dhunës në marrdhënie familjare", lidhur me detyrimin ligjor të institucioneve lokale për të kryer përgjegjësitë e tyre në adresimin e rasteve të dhunës. Monitorim i adresimit të rasteve të dhunës në zonat rurale tregon se për to bashkitë duhet të kenë planifikojnë buxhetim të veçantë.
Nga të dhënat rezulton se vetëm në disa prejt MKR-ve takimi periodik çdo muaj i ETN-ve është realizuar në mëyrë periodike sic ligji e parashikon, ndërkohë bashkitë e tjera kryesisht kanë realizuar takime vetëm në raste raportimi dhune apo në raste të tjera. Gjetjet tona rezultojnë si më poshtë:

**VITI 2020: 32 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 16 RASTE DHUNE**

**Bashkia Vorë:** Viti 2020: 32 raste dhune Viti 2021: 16 raste dhune Sipas raportimeve Bashkia Vorë nuk ka të emëruar koordinatorin e dhunës për vitin 2021 si dhe ETN nuk është mbledhur. Puna për monitorimin e rasteve është realizuar nga punonjës të shërbimit social në bashkëpunim me organizatat. Bashkia ka justifikuar mungesën e mbledhjeve të MKR dhe koordinatorit për shkak të procesit të rikonstrusionit të godinës ndaj ka dhe mungesa të mbledhjeve Gjithashtu Bashkia ka bashkëpunuar me policinë, qendrat shëndetësore prokurorinë dhe gjykatën.

**VITI 2020: 18 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 10 RASTE DHUNE**

**Bashkia Mat:** Në Bashkinë Mat MKR është ngritur dhe është bërë funksional që në vitin 2019. Në mënyrë periodike dhe sipas rasteve mblidhet ETN për të diskutuar, menaxhuar dhe asistuar nevojat e rasteve. Rastet e diskutuara në ETN janë të të mbijetuarave të dhunës në marrëdhëniet familjare të cilat janë pajisur me UMM dhe UM. Bashkëpunimi ndëristitucional është për tu vlerësuar.

**VITI 2020: 7 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 6 RASTE DHUNE**

**Bashkia Gramsh:** MKR -ja në bashkinë Gramsh ka funksionuar rregullisht dhe mbledhjet janë zhvilluar në mënyrë periodike. Prezent kanë qënë aktorët që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejt me rastet për t'i ofruar shërbimet e nevojshme në bazë të problematikave të paraqitura dhe vlersimeve të bëra. Gjithashtu me organizata të shoqërisë civile janë zhvilluar takime me ETN-në duke i informuar më shumë për ndryshimet ligjore dhe detyrimet që ata si aktorë kanë në bazë të insitucionit që përfaqësojnë.

**VITI 2020: 17 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 35 RASTE DHUNE**

**Bashkia Devoll:** MKR funksionon që prej vitit 2018. Jane zhvilluar mbledhje periodike të ETN me të gjithë aktorët përkates, në varësi edhe të specifikave që kanë shfaqur rastet e dhunës në familje, për tu njohur me rastet, problematikat e tyre dhe adresimin e shërbimeve në varësi të nevojave.

**VITI 2020: 497 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 632 RASTE DHUNE**

**Bashkia Durres:** janë organizuar 10 mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisiplinor GTN.

**VITI 2020: 19 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 16 RASTE DHUNE**

**Bashkia Patos:** Gjatë vitit 2021, ETN-ja është mbledhur rregullisht dhe ka zhvilluar mbledhjet e përmuajshme, me qëllim ndarjen e informacioneve mbi rastet e reja dhe ecurinë e trajtimit të rasteve ekzistuese. Mbledhja periodike janë zhvilluar kryesisht online.

**VITI 2020: 5 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 6 RASTE DHUNE**

**Bashkia Tepelenë:** Sipas raportimeve të kësaj bashkie, ETN-ja ka funksionuar dhe është mbledhur periodikisht çdo muaj. Përmes koordinimit, komunikimit dhe bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve për të identifikuar, referuar dhe për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje, braktisjeve, etj, ka nisur procesin mbështetës, që përfshin mbrojtje të menjëhershme dhe siguri nga policia, shoqërim për mbështetje shëndetësore nga stafi mjekësor lokal dhe në çdo rast janë shoqëruar nga punonjësja sociale në Bashki. Për një rast i shqyrtuar me MKR & ETN, për një burrë të moshës së tretë, të vetmuar, kanë nisur procedurat dhe janë përfunduar, duke e akomoduar në shtëpinë e të moshuarve, në Gjirokastër. Rastet janë raportuar edhe në takimet e Këshillit Bashkiak, pas raportimit të zyrë së çështjeve sociale të Komisioni i Barazisë Gjinore.

**VITI 2020: 58 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 63 RASTE DHUNE**

**Bashkia Pogradec:** Mekanizmi i Referimit të Rasteve ka funksionuar normalisht sipas marrëveshjes që është nënshkruar midis antarëve të Mekanizmit dhe ETN gjatë vitit 2021 është mbledhur 8 herë për të diskutuar rastet të cilat kanë pasur nevojë për një bashkëpunim institucional por edhe për të identifikuar problematikat e hasura gjatë punës në terren.

**VITI 2020:0 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 8 RASTE DHUNE**

**Bashkia Konispol:** Për vitin 2021 ka zhvilluar sipas protokollit të dhunës në familje 12 mbledhje në vit të ETN, një mbledhje në muaj dhe 2 mbledhje në vit për MKR. Ka patur raste dhune që ETN është mbledhur tri herë.

**VITI 2020: 104 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 98 RASTE DHUNE**

**Bashkia Lezhë:** Gjatë 2021 MKR në bashkinë Lezhë ka mirëfunksionuar Komiteti drejtues dhe anëtaret e ETN kanë qenë të gatshëm për të bashkëpunuar për çdo rast. Mbledhjet janë mbajtur një herë në muaj pra, 12 takime. Janë menaxhuar raste, është bërë koordinim shërbimesh, raporte mujore, 3 mujore dhe 6 mujore, 1 vjeçare mbi problematikat e ndeshura.

**VITI 2020: 2 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 0 RASTE DHUNE**

**Bashkia Përmet:** MKR & ETN-ja ka funksionuar gjatë 2021. Takimet janë realizuar periodikisht çdo muaj. Për këtë ka një marrëveshje ndërinstitucionale, që respektohet. Gjithashtu rastet raportohen periodikisht edhe në takimet e Këshillit Bashkiak, nëpërmjet bashkëpunimit me Komisionin e Barazisë Gjinore në KB PR.

**VITI 2020: 0 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 10 RASTE DHUNE**

**Bashkia Memaliaj:** MKR ka funksionuar dhe është mbledhur 2 herë/muaj. Po kështu edhe ETN-ja ka funksionuar, për sa i përket koordinimit, komunikimit dhe bashkëpunimit, për të identifikuar dhe referuar raste të dhunës në familje. Rastet kanë qenë dhunë fizike e bashkëshortëve ndaj bashkëshorteve, e familjarëve të tjerë ndaj grave të familjes, por edhe e prindërve ndaj fëmijëve. Rastet janë raportuar në Komisionin e Barazisë Gjinore dhe relatuar në takimet e Këshillit Bashkiak.

**VITI 2020: 3 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 0 RASTE DHUNE**

**Bashkia Delvinë:** Për vitin 2021, MKR ka funksionuar dhe është mbledhur çdo muaj. Me ETN-në, janë realizuar 2 takime, ku të pranishëm kanë qenë edhe përfaqësues të UNDP. Është diskutuar për menaxhimin, koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve për të identifikuar, referuar dhe për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje në kohë dhe me efiçencë. Nga UNDP-ja janë bërë edhe trajnime për dhunën në familje.

**VITI 2020:22 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 38 RASTE DHUNE**

**Bashkia Rrogozhinë:** Gjatë vitit 2021 janë mbajtur 12 mbledhje me ETN dhe 3 takime me Komitetin Drejtues.

**VITI 2020: 119 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 99 RASTE DHUNE**

**Bashkia Korçë** raporton se gjatë vitit 2021 bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë dhe ka patur rezultate pozitive në menaxhimin e rasteve të të mbijetuarve të dhunës në familje. Janë realizuar mbledhjet periodike multidisiplinare kundër dhunës në familje rregullisht, konkretisht janë organizuar 7 të tilla, 3 prej tyre mbledhje urgjente.

**VITI 2020: 5 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 1 RAST DHUNE**

**Bashkia Këlcyrë:** Thekson se për vitin 2021, MKR është mbledhur 1 herë/3 muaj. Duke qenë se në këtë bashki është evidentuar vetëm një rast dhune në 2021 nga 5 të tilla në 2020, raportohet se për këtë rast është bashkëpunuar me strukturat policore në Këlcyrë. Menjëherë është nisur procesi mbështetës me shërbime afat-shkurtra, që përfshijnë mbrojtje të menjëhershme dhe siguri nga policia, shoqërim për mbështetje shëndetësore nga stafi mjekësor zonal dhe psikologia Linjës së Këshillimit për gra dhe vajza. Në të njëjtën kohë, u hap dosja, u shqyrtua rasti nga zyra e çështjeve sociale në Bashki dhe u suportuar me ndihma konkrete.

**VITI 2020: 6 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 6 RASTE DHUNE**

**Bashkia Dibër** raporton se MKR-ja ka realizuar takime periodike mbi menaxhimin e rasteve të dhunës në familje të referuara si nga organizata edhe nga institucione të ndryshme dhe kanë bashkëpunuar për zgjidhjen e rastit.

**VITI 2020: 7 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 9 RASTE DHUNE**

Nga raportimi i **Bashkisë Tropojë** përcaktohet se mirëfunksionon MKR-ja me të gjithë pjestarët e saj. MKR mblidhet çdo tre muaj si dhe sa herë ka raste emergjente si dhe diskuton rreth problematikave të ndodhura gjatë periudhës si dhe marrin përsipër detyrimet përkatëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

**VITI 2020: 31 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 31 RASTE DHUNE**

Për vitin 2021 **Bashkia Librazhd** raporton se MKR ka funksionuar duke demostruar angazhim maksimal të të gjitha palëve përgjegjëse. Janë zhvilluar mbledhje të ETN si dhe sipas nevojave të rastit, janë thirrur dhe mbledhje urgjente.

**VITI 2020: 12 RASTE DHUNE**
**VITI 2021:14 RASTE DHUNE**

**Bashkia Bulqizë** gjatë vitit 2021 raporton se MKR-ja ka funksionuar dhe janë realizuar takime periodike. Janë identifikuar nevojat për secilin rast si edhe janë dhënë shërbimet përkatëse. Gjithsej janë realizuar 6 takime të grupit te ETN-së.

**VITI 2020: 30 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 31 RAST DHUNE**

**Bashkia Kukës** raporton se ETN gjatë vitit 2021 është mbledhur periodikisht dhe ka trajtuar rastet e dhunës duke hartuar planet specifike të ndërhyrjes për secilin rast. Gjithashu është rinovuar marrëveshja me 13 institucionet lokale pjesë e MKR.

**VITI 2020: 35 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 15 RASTE DHUNE**

**Bashkia Ura Vajgurore** deklaron se janë realizuar mbledhje të vazhdushme të (ETN-së) në rastet specifike të dhunës janë marrë vendime në lidhje me ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës.

**VITI 2020: 32 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 47 RASTE DHUNE**

**Bashkia Kurbin** raporton se është ngritur MKR dhe ka zhvilluar mbledhje rregullisht për menaxhimin e rasteve të dhunës për të cilët është siguruar strehim dhe këshillim psikologjik.

**VITI 2020: 24 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 70 RASTE DHUNE**

**Bashkia Krujë** raporton se gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 5 mbledhje të ETN-së, si dhe MKR-ja ka funksionuar normalisht me një bashkëpunim të ngushtë të të gjithë aktorëve kryesorë.

**VITI 2020: 7 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 16 RASTE DHUNE**

**Bashkia Klos** për vitin 2021 janë realizuar 6 takime me ETN, dy raste kanë qenë për trajnimin e ETN pasi rinënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit të MKR (me projektin e PNUD), ndërsa takimet e tjera kanë qenë për trajtimin e rasteve. Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë i mirë.

**VITI 2020: 125 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 149 RASTE DHUNE**

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë **Bashkisë Kamëz** për gjatë vitit 2021 ka ndjekur dhe trajtuar rastet e dhunës sipas nevojave dhe specifikave që secili rast ka patur (dhunë fizike dhe psikologjike). Gjatë vitit 2021 janë evidentuar 149 raste dhune në familje pranë Komisariatit të Policisë nr.5. Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Kamëz ka trajtuar në bashkëpunim me Koordinatoren vendore kundër dhunës në familje, specialistët e mbrojtjes së fëmijëve/barazisë gjinore dhe anëtarët e mekanizmit 67 raste të të mbijetuarave të dhunës në familje. Mekanizmi i Referimit së bashku me anëtarët janë mbledhur çdo muaj. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit së bashku me Koordinatoren vendore kanë kontribuar në ndjekjen sa më efektive dhe plotësimin e nevojave të të mbijetuarave të dhunës në familje duke siguruar adresimin në shërbimet përkatëse.

**VITI 2020: 32 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 29 RASTE DHUNE**

**Bashkia Berat:** ETN-ja ka zhvilluar 3 takime për 3 raste të cilat kanë pasur nevoja specifike pasi dhuna ka përfshirë edhe fëmijët. Gjatë takimeve të ETN-së është diskutuar për mbështetjen dhe fuqizimin e rasteve në vazhdim, ndërmjetësim për punësimin e tyre, ndjekjen e kurseve profesionale falas nga OJF, regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, kopësht. MKR është mbledhur një herë gjatë 2021, në përgatitjen e aktiviteteve për 16 ditët kundër dhunës me bazë gjinore, ku takimi i parë ka qënë me MKR ku është diskutuar mbi sfidate menaxhimit të rasteve, nevoja për mbështeteje nga institucionet, etj.

VITI 2020: 794 RASTE DHUNE
VITI 2021: 752 RASTE DHUNE

**Bashkia Tiranë** Gjatë vitit 2021, (MKR) Tiranë ka arritur të trajtojë 752 raste të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë mbledhjeve të Ekipit Teknik Ndërdisiplinar (ETN) me anëtare të MKR Tiranë. 156 raste janë asistuar dhe trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Koordinatorja Vendore. Në lidhje me programin e ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, nga fondi i kushtëzuar dhe buxheti i Bashkisë Tiranë, për vitin 2021 kanë përfituar gjithsej 2439 familje: 178 të mbijetuar/a dhune, 283 gra kryefamiljare dhe 5 të mbijetuar/a trafikimi.

Përfitues shërbimesh në qendrat komunitare për vitin 2021 rezultojnë:

- Qendra Komunitare Multidisiplinare: 586, nga të cilët 159 gra.
- Qendra Komunitare Shkozë: 466 përfitues gjithsej, nga të cilar 226 gra.
- Qendra Komunitare "Të Qëndrojmë së Bashku" 150 përfitues gjithsej, 77 gra.
- Qendra Komunitare "Streha" 61, 22 gra.
- Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi" 502 përfitues gjithsej, nga të cilët 198 gra.
- Qendra Komunitare "Terreni" - 464 gjithsej, nga të cilët 222 gra.

Në lidhje me strehimin social programet të cilat janë vënë në zbatim nga Bashkia Tiranë për vitin 2021 janë:
MKR Tiranë menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor, koordinim me të gjithë aktorët e rrjetit, këto në interes të të mbijetuarave. Ky Mekanizëm ka reaguar menjëherë dhe me përgjegjësinë e duhur me shërbimet e mëposhtme të cilat janë FALAS.

VITI 2020: 234 RASTE DHUNE
VITI 2021: 244 RASTE DHUNE

**Bashkia Vlorë:** Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë realizuar sipas rastit takimet e ETN ku të gjithë aktorët kanë qenë pjesëmarrës aktivë dhe kanë reaguar menjëherë në ofrimin e shërbimeve përkatese. Janë ofruar në kohë të gjitha shërbimet e nevojshme në bazë të vlerësimit të nevojave, sic janë shërbime ligjore, asistencë dhe këshillime psikologjike, orientim dhe ndërmjetësim për aplikim për të përfituar ndihmën ekonomike në rastet kur të mbijetuarat janë pajisur me UM Ndërmjetësim dhe referim pranë zyrës së punësimit për të mbijetuarat që kërkojnë të regjistrohen pranë këtij institucioni për tu punësuar. MKR e ngritur në shkurt të vitit 2012 ka funksionuar mjaft mirë dhe ka bashkëpunuar me menaxhimin e çdo rasti të paraqitur apo referuar si nga organet policore ashtu edhe nga OJF apo qendrat shëndetësore etj. MKR e bashkisë Vlorë tashmë është konsoliduar dhe përmirësuar për t'iu përgjigjur sa më efektivisht problematikave që sjell DHBGJ dhe DHF. Së fundmi është rinovuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit të MKR.

**VITI 2020: 3 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 4 RASTE DHUNE**

**Bashkia Selenicë:** Gjatë vitit 2021 janë realizuar sipas rastit takimet e ETN. Janë ofruar të gjitha shërbimet nevojshme për të mbijetuarat e dhunës si asistencë ligjore, psikologjike, është ofruar ndihmë ekonomike kur të mbijetuarat janë pajisusr me UM. Ndërmjetësim dhe referim pranë zyrës së punësimit për të mbijetuarat që kërkojnë të regjistrohen pranë këtij institucioni për t'u punësuar. MKR ka funksionuar mjaft mirë dhe ka bashkëpunuar me menaxhimin e çdo rasti të paraqitur apo referuar si nga organet policore ashtu edhe nga OJF apo qendrat shëndetësore.

**VITI 2020: 1 RAST DHUNE**
**VITI 2021: 10 RASTE DHUNE**

**Bashkia Skrapar:** Janë zhvilluar 3 takime në ETN 1. Takim me policinë në lidhje me Protokollin e Menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, në lidhje me arsimin dhe shëndetësinë përsa i takon rolit të tyre në menaxhimit të rasteve të dhunës.

**VITI 2020: 100 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 76 RASTE DHUNE**

**Bashkia Lushnj ë**raportohet se MKR drejtohet nga Bashkia dhe ka koordinuar punën së bashku me institucionet e tjera përgjegjëse ku raportohen: 76 të mbijetuara të dhunës në familje, ofruar këshilllim psikologjik, për 49 të mbijetuara është ofruar mbështetje ligjore falas, janë kryer 26 aktivitete informuese, 5 viktima të mbështetura me strehim të përkohshem dhe 40 personave iu është ofruar shërbimi i trajnimit.

**VITI 2020: 121 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 150 RASTE DHUNE**

**Bashkia Shkodër** gjatë vitit 2021 ka monitoruar 150 raste me raporte të specifikuara për secilin rast në bashkëpunim me drejtorinë vendore të policisë së shtetit. Në lidhje me këtë bashki nuk kemi një raportim të qartë përsa i takon funksionimit të MKR-së.

**VITI 2020: 2 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 9 RASTE DHUNE**

**Bashkia Has** raporton se MKR-ja në Bashkine Has është ngritur që në dhjetor të 2019, dhe vazhdimisht janë organizuar takime të KD dhe ETN-së ku janë diskutuar rastet, shërbimet që do ofrojmë, menaxhimi i tyre, ndryshimet ligjore, protokollet e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Janë organizuar takime ndërgjegjësuese me komunitetin dhe nxënësit në shkolla, konkurse esesh për nxënësit e shkollave, aktivitete gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje. Qendra e keshillimit të grave dhe shërbimeve sociale Kukës

**VITI 2020: 2 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 2 RASTE DHUNE**

**Bashkia Finiq** raporton se për vitin 2021, ETN-ja nuk ka funksionuar, por MKR është mbledhur 4 herë, 1/3 muaj, në lidhje me koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve për të identifikuar, referuar dhe për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje. Në të gjitha rastet e raportuara për dhunë psikologjike, është realizuar mbështetja me shërbime afat-shkurtra, që përfshijnë mbrojtje të menjëhershme dhe siguri nga policia, shoqërim për mbështetje shëndetësore nga psikologu i vendosur nga Bashkia, si edhe koordinatorja vendore në Bashki. Në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar rastet nga zyra e çështjeve sociale në Bashki dhe janë suportuar me ndihma konkrete. Rastet janë raportuar edhe në takimet e Këshillit Bashkiak.

VITI 2020: 5 RASTE DHUNE
VITI 2021: 10 RASTE DHUNE

**Bashkia Mallakastër:** Për vitin 2021, MKR ka funksionuar dhe është mbledhur 4 herë, 1/3 muaj. Edhe ETN-ja ka funksionuar, për sa i përket koordinimit, komunikimit dhe bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve për të identifikuar, referuar dhe për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje. Të gjitha rastet kanë qenë dhunë fizike e bashkëshortëve. Mbështetja e ofruar ka qenë me shërbime afat-shkurtra, që përfshijnë mbrojtje të menjëhershme dhe siguri nga policia, shoqërim për mbështetje shëndetësore nga stafi mjekësor zonal dhe psikologia e punonjësja sociale në Bashki. Në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar rastet nga zyra e çështjeve sociale në Bashki dhe janë suportuar me ndihma konkrete.

VITI 2020: 1 RASTE DHUNE
VITI 2021: 0 RASTE DHUNE

**Bashkia Dropull:** Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar disa mbledhje të ETN-së. Ndryshe nga Bashkitë e tjera Bashkia Dropull ka ndjekur një seminar trajnues ku pjesëmarresit u njohën me ndryshimet më të fundit të ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje-roli detyrat dhe përgjegjësitë e antarëve, bazuar në legjislacionin e përditësuar, duke u ndalur tek detyrat dhe përgjegjësitë e administratorëve shoqërorë, përdorimin e protokolleve të menaxhimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Njohjen me formularët dhe mënyrën e plotësimit të tyre. Ky trajnim u organizua nga Bashkia Dropull dhe u mbështet nga UNDP Shqipëri në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund Dhunës Ndaj Grave në Shqipëri" me fonde të Qeverisë Suedeze. Përmirësimi i funksionimit të MKR në nivel vendor, mbetet një sfidë e vazhdueshme por rritja e njohurive dhe investimi në kapacitetet pjesë përbërëse të Mekanizmit janë një hap i rëndësishëm në luftën ndaj dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

VITI 2020: 15 RASTE DHUNE
VITI 2021: 18 RASTE DHUNE

**Në Bashkinë e Himarës** mbledhjet e MKR-së nuk zhvillohen me të gjithë anëtarët e trupës së mekanizmit për shkak të distancës dhe angazhimeve institucionale që ata kanë. Nga ana tjetër evidentohen që aktorët pjesëmarrës janë të gatshëm dhe marrin pjesë nëpër takime.

VITI 2020: 124 RASTE DHUNE
VITI 2021: 144 RASTE DHUNE

**Bashkia Elbasan:** Raporton se ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me aktorët lokalë për ngritjen dhe funksionimin e MKR-së. Takimet janë realizuar të rregullta bazuar në protokollin përkatës. Gjatë vitit 2021 MKR ka menaxhuar 144 raste të dhunës në familje, 125 raste konsulence ligjore, 9 raste strehim emergjent, 19 raste mbeshtetje ekonomike, 82 raste ndihmë ekonomike, raste me UM, 110 pako ushqimore, 15 raste bonus qeraje, 103 raste blerje ilaçe, 52 raste referim kurse profesionale, 15 raste punësimi, 8 fëmijë të regjistruar falas në çerdhe, 90 raste monitorim për zbatimin e masave mbrojtëse nga gjykata.

**VITI 2020: 48 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 52 RASTE DHUNE**

**Bashkia Kavajë:** Funksionimi i MKR-së në Bashkinë Kavajë ka nisur në vitin 2015. Gjatë vitit 2022 janë trajtuar 52 raste të të mbijetuarave të dhunës, janë trajtuar me këshillim psiologjik dhe shërbim ligjor falas 32 të mbijetuara. Me ndihmën e MKR-së janë realizuar 22 aktivitete informuese dhe 2 të mbijetuara kanë marrë strehim të përkohshëm. Gjithashtu është realizuar edhe rritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve. Lidhur me mbledhjet e kryera të MKR-së dhe ETN-së Bashkia e Kavajës nuk ka siguruar një informacion specifik.

**VITI 2020: 79 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 52 RASTE DHUNE**

**Bashkia Sarandë:** Raporton se pavarësisht themelimit të MKRS-së në vitin 2015, vetëm në qershor të vitit 2021 është rinëshkruar marrëveshja duke shtuar disa institucione dhe organizata që operojnë në qytetin e Sarandës. Janë realizuar **5 mbledhje ETN** me problematika të ndryshme ku ka qënë i nevojshëm konsultimi me të gjithë aktorët pasi kanë qenë raste sensitiv, <u>ndërkohë që për rastet e të mbijetuarave të dhunës është punuar individualisht dhe në bashkëpunim me aktorët e ETN pa qenë nevoja për tu mbledhur të gjithë aktorët.</u>

**VITI 2020: 85 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 115 RASTE DHUNE**

**Bashkia Fier:** Raporton se janë realizuar takime të MKR-së për rastet e dhunës në familje por shumë të reduktuara për shkak të pandemisë, dhe përgjithësisht janë mbajtur vetëm takime telefonike. Edhe takime e ETN-së kanë qenë të reduktuara vetëm për rastet emergjente.

**VITI 2020: 18 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 15 RASTE DHUNE**

**Bashkia Shijak:** Gjatë vitit 2021 ka realizuar 3 mbledhje të ETN me përfaqesues nga shumica e institucioneve anëtare të MKR. Në këto takime janë ndarë detyrat dhe ka vijuar bashkëpunimi për menaxhimin e rasteve të dhunës.

**VITI 2020: 3 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 4 RASTE DHUNE**

**Bashkia Pukë** raporton se në vitin 2020 është ngritur MKR me ndihmën e shoqatës "Gruaja tek Gruaja" dhe ka vijuar funksionimin edhe në 2021. MKR mblidhet ne mënyrë periodike dhe sa herë ka raste për referim.

**VITI 2020: 15 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 7 RASTE DHUNE**

**Bashkia Mirditë:** Në bashkinë Mirditë është ngritur MKR dhe ka organizuar takime për menaxhim rastesh dhe referim në bashkëpunim me aktorët lokalë.

**VITI 2020: 15 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 7 RASTE DHUNE**

**Bashkia Peqin:** Grupi ETN mblidhet kur ka raste të nevojshme, të menjëhershme dhe kur kërkohet ndërhyrje emergjente.

**VITI 2020: 24 RASTE DHUNE**
**VITI 2021: 27 RASTE DHUNE**

**Bashkia Prrenjas** Mekanizmi i Referimit të rasteve në bashkinë Prrenjas është mbledhur në raste të veçanta si rastet me UM, braktisje fëmijësh, të moshuar etj.

VITI 2020: 18 RASTE DHUNE
VITI 2021: 30 RASTE DHUNE

**Bashkia Maliq:** MKR ka funksionuar dhe është bërë mbledhja e saj sa herë ka qenë e nevojshme.

VITI 2020: 4 RASTE DHUNE
VITI 2021: 11 RASTE DHUNE

**Bashkia Belsh:** Gjatë vitit 2021 ETN ka zhvilluar 1 mbledhje për diskutimin e rasteve të paraqitura.

VITI 2020: 26 RASTE DHUNE
VITI 2021: 26 RASTE DHUNE

**Bashkia Kuçovë** raporton se gjatë vitit 2021 MKR ka menaxhuar me sukses rastet e dhunës.

VITI 2020: 2 RASTE DHUNE
VITI 2021: 5 RASTE DHUNE

**Bashkia Poliçan:** Raporton se gjatë vitit 2021 në mbështetje me UNDP është bërë e mundur ngritja e zyrës së KVDHF, i cili ndihmoi edhe në procesin për ngritjen dhe funksionimin e MKR. Janë realizuar 5 takime.

VITI 2020: 32 RASTE DHUNE
VITI 2021: 37 RASTE DHUNE

**Bashkia Gjirokastër:** Raporton se është mbledhur ETN për 3 raste për marrjen e masave të menaxhimit të rasteve të dhunës.

VITI 2020: 26 RASTE DHUNE
VITI 2021: 28 RASTE DHUNE

**Bashkia Roskovec:** Gjatë vitit 2021 MKR ka qënë aktiv në identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve. Mekanizmi i Kordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje mblidhet rregullisht. Në mbledhjet e kryera të ETN-së ndër të tjera diskutohet identifikimi i rasteve të dhunës në familje, trajtimi i rasteve aktive sipas VKM-së përkatëse.

VITI 2020: 6 RASTE DHUNE
VITI 2021: 21 RASTE DHUNE

**Bashkia Vau i Dejës:** Gjatë vitit 2021 raporton se ETN është mbledhur 2 herë ku janë diskutuar shërbimet që do të ofrohen për të mbijetuarat e dhunës.

VITI 2020: 1 RASTE DHUNE
VITI 2021: 1 RASTE DHUNE

**Bashkia Pustec:** Nëpërmjet një projekti të UNDP, bashkia ka ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit si dhe është realizuar rritja e kapaciteteve të anëtarëve të MKR. Takimet e ETN janë zhvilluar rregullisht ndërkohë që nëpërmjet projektit të UNDP është ndihmuar funksionimi i Mekanizmit, janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuese dhe shkëmbim përvojash.

VITI 2020: 28 RASTE DHUNE
VITI 2021: 46 RASTE DHUNE

**Bashkia Divjakë:** Raporton se ka patur një bashkëpunim shumë të mirë midis institucioneve dhe MKR për menaxhimin e rasteve të dhunës. Bashkia ka mundësuar bonus qeraje në raste të evidentimit të viktimave të dhunës si dhe janë bërë përpjekje për mbajtjen e distancës midis dhunuesit dhe të dhunuarës.

VITI 2020: 28 RASTE DHUNE
VITI 2021: 46 RASTE DHUNE

**Bashkia Cërrik:** Mekanizmi i Kordinuar i Referimit pranë bashkisë Cërrik është ngritur në vitin 2018, por nuk është funksional. Bashkëpunimi me Komisariatin e Policisë Cërrik është shumë efektiv, pasi është i vetmi institucion që referon dhe adreson problematikat e të mbijetuarave të dhunës në familje pranë Sektorit Social.

VITI 2020: 2 RASTE DHUNE
VITI 2021: 15RASTE DHUNE

**Bashkia Kolonjë** raporton se ETN ka kryer mbledhjen e saj periodike çdo muaj (12 takime), duke diskutuar për masat e marra të mbrojtjes, monitorimin e tyre, ofrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për reintegrimin e tyre në shoqëri, ofrim të paketës së shërbimeve mbështetëse, fuqizimi ekonomik. Janë trajtuar gjithësej 15 raste për vitin 2021.

VITI 2020: 125 RASTE DHUNE
VITI 2021: 149 RASTE DHUNE

**Bashkia Kamëz** raporton se MKR gjatë vitit 2021 për 149 rastet e evidentuara ka trajtuar në bashkëpunim me Kordinatoren vendore kundër dhunës në familje, specialistët e mbrojtjes së fëmijëve/barazisë gjinore dhe anëtarët e mekanizmit 67 raste të të mbijetuarave të dhunës në familje. Mekanizmi i Referimit së bashku me anëtarët janë mbledhur çdo muaj. Mekanizmi i Kordinuar i Referimit së bashku me Kordinatoren vendore kanë kontribuar në ndjekjen sa më efektive dhe plotësimin e nevojave të të mbijetuarës së dhunës në familje duke siguruar adresimin në shërbimet përkatëse.

***Në lidhje me Mbledhjet e MKR dhe ETN evidentojmë Bashkinë e Fierit ku rastet e dhunës janë rritur ndjeshëm nga viti 2020-2021 (85-115) mbledhja në mënyrë të rregullt dhe periodike e mekanizmave të sipërcituar do të mundësonte një menaxhim më të mirë të situatave të dhunës në kushtet kur rastet e evidentuara janë në rritje. Nga ana tjetër edhe Bashkia e Vlorës me një numër të lartë rastesh dhune për 2021 (234) ka nevojë për organizimin e takimeve periodike ashtu si ligji e parashikon, jo vetëm në raste të posaçme, për të cilat sipas ligjit mbledhjet e ETN duhet të realizohen përveç takimeve periodike të përmuajshme. Gjithashtu Bashkia Maliq raporton një numër pothuaj të dyfishuar të rasteve të dhunës për vitin 2021, pavarësisht kësaj mbledhja e ETN është kryer vetëm në rastet e posaçme dhe jo në mënyrë periodike.***

## VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MEKANIZIMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR) NGA ANA E ORGANIZATAVE PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRGJATË VITIT 2021

Sipas vlerësimit të organizatave në Finiq, Kuçovë dhe Këlcyrë puna e MKR-së është në nivelin jo mirë ndaj ka nevojë për përmirësim.

Ndërkohë Bashkia Elbasan, Gjirokastër, Lezhë, Kavajë, etj janë vlerësuar në nivelin shumë mirë në lidhje me funksionimin e MKR.

Organizata që operon në Bashkinë Mat ka raportuar se MKR nuk është ngritur në Mat




**Grafik i pasqyrimit të këndvështrimit të OJF-ve për punën e MKR gjatë 2021**

## KOORDINATORI KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE:

Referuar parashikimeve të ligjit, Koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare është punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ai kryen raportimin dhe identifikimin e rastit të dhunës në familje përmes:
a) verifikimit të raportimeve nga personi i dhunuar;
b) referimit të rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit;
c) referimit të rastit nga çdo institucion i përfaqësuar në ETN;
ç) verifikimit të raportimeve nga çdo person tjetër fizik a juridik, publik ose privat;
d) verifikimit të njoftimeve nga media e shkruar, elektronike ose mediat sociale.
Referuar sa më sipër, roli i koordinatorit është një rol kyç në funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit por edhe për komunitetin ku jeton si receptori kryesor i rasteve të dhunës. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet situata lidhur me angazhimin e punonjësve në bashkitë e intervistuara. Pavarësisht se në shumicën e Bashkive të vendit Koordinatori Vendor punon me kohë të plotë në 8 Bashki (Tepelenë, Shijak, Sarandë, Himarë, Skrapar, Pukë dhe Poliçan) koordinatori vendor punon me kohë të pjesshme apo është i ngarkuar me detyra të tjera administrative si specialist, përgjegjës sektori etj.

Ndërkohë rezulton se Shkodra, një nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me numër të lartë të rasteve të raportuara për dhunë, është në proces rekrutimi dhe nuk ka ende një koordinator vendor. Edhe në Bashkinë e Kurbinit nuk ka një punonjës të emëruar në këtë detyrë, e cila kryhet nga Përgjegjësja e Sektorit.

Plotësimi i detyrimit i të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore për të emëruar punonjëse/punonjës me kohë të plotë në pozicionin vetëm të Koordinatores/Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje, në zbatim të detyrimit që rrjedh nga legjislacioni në fuqi, vazhdon të mbetet një tjetër sfidë e pa adresuar në mënyrën e duhur, në këtë periudhë kohore.

*Fuqizimi i kapaciteteve të Koordinatoreve / Koordinatorëve Vendorë për të njohur dhe parashtruar në mbledhjet e Komiteteve Drejtuese të MKR-ve, nevojën për aplikimin e ndëshkimeve sipas legjislacionit në fuqi, do të ndihmonte edhe më shumë në luftën dhe parandalimin e dhunës në kohët kur shifrat na tregojnë rritje të vazhdueshme të rasteve të raportuara*




Referuar të dhënave që raportojnë Bashkitë lidhur me pozicionin e Koordinatorit Vendor Kundër Dhunës në Familje rezulton se:

- Në **Bashkinë Kurbin, Durrës dhe Vorë** nuk ka Koordinator të emëruar, ky pozicion mbulohet nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Në **Bashkinë Skrapar**, Koordinatorja ka edhe një pozicion tjetër pune në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore.
- Në **Bashkinë Tepelenë,** Koordinatori ka edhe detyra të tjera të ngarkuara.
- Në **Bashkinë Polican,** Koordinatori është i punësuar me kohë të pjesshme si dhe mban detyrën e Përgjegjësit të Sektorit.
- Në **Bashkinë Sarandë,** Koordinatori është i punësuar me kohë të pjesshme, po ashtu në Bashkinë e Pukës, Roskovecit dhe Shijakut.
- Në **Bashkinë Shkodër,** pozicioni i koordinatorit është bosh pasi institucioni është në proces rekrutimi. Sipas parashikimeve koordinatori që do të emërohet në këtë pozicion, do të punësohet me kohë të plotë.

## MONITORIMI I URDHËRAVE TË MBROJTJES

**BASHKIA KAMËZ**

Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje, si dhe punonjësit e barazisë gjinore të emëruar në lagje/NJA, kanë përmbushur detyrimin ligjor sa i takon monitorimit të urdhërave të mbrojtjes, nëpërmjet përgatitjes së raportit të posaçëm për të mbijetuarat e dhunës në familje. UM monitorohen çdo 60 ditë për cdo rast në menaxhim dhe çdo raport i vihet në dispozicion Komisariatit të Policisë për zbatimin e masave të vendosura në vendimin e gjykatës nëse janë zbatuar apo shkelur. Gjatë monitorimeve nuk është hasur vështirësi pasi rastet kanë treguar situatën mes tyre dhe dhunuesit.

**BASHKIA PRRENJAS**

Koordinatoi Vendor ka realizuar Monitorimin e UM për të plotësuar raportin e 60 ditëshit.

**BASHKIA RROSKOVEC**

Situata e monitorimit të zbatueshmërisë të urdhërave të mbrojtjes mbahet në monitorim jo vetëm përmes vizitave në banesë dhe intervistave çdo 60 ditë por edhe përmes kontaktit të vazhdueshëm telefonik me viktimat e dhunës në familje për të monitoruar çdo nevojë që ato mund të kenë. Lidhur me zbatueshmërinë e urdhërave të mbrojtjes apo të mbështetjes psiko-sociale, zakonisht policia mbahet në kontakt të vazhdueshëm mbi ecurinë e urdhërave të mbrojtjes por shumë pak raporte monitorimi janë plotësuar dhe janë dërguar në formë shkresave policisë kjo dhe për faktin se pozicioni i koordinatorit vendor ka qënë një pozicion me kohë të pjesshme dhe ka qënë me detyrë dytësore dhe jo gjithmonë mund të mbulohej saktësisht sipas detyrimit ligjor duke qënë se dhe vetë pozicioni i koordinatorit vendor me kohë të pjesshme nuk i përmbush detyrimet e kuadrit ligjor në fuqi.

**BASHKIA VAU I DEJËS**

Monitorimi i Urdhërave të Mbrojtjes realizohet çdo 60 ditë. Informacioni i mbledhur i dërgohet zyrtarisht me shkresë Policisë si dhe me email.

**BASHKIA PUSTEC**

Monitorimi i Urdhrave të Mbrojtjes është realizuar përmes kontakteve telefonike dhe nëpërmjet takimeve të ETN.

**BASHKIA DIVJAKË**

Monitorimi në Bashkinë Divjakë ka qenë disi i vështirë sepse shpesh herë nuk është gjetur mirëkuptimi nga ana e të mbijetuarave të dhunës, si dhe në disa të tjera bashkëshorti ka jeuar në të njëjtën banesë me të mbijetuarën e dhunës. Në çdo rast ka qenë prezent Specialisti i Policisë së Zonës si dhe janë përkrahur nga policia në përgjithësi.

**BASHKIA TIRANË**

Raportet e monitorimit të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore është mbështetur me një konsulent për Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të Dhunës në Familje, kontraktuar nga UN Women Albania për periudhën prill-dhjetor 2021. 162 raporte monitorimi për zbatimin e urdhrave të mbrojtjes janë dërguar në komisariatet përkatëse të policisë. Janë gjithsej 90 raste, për të cilat raportet e monitorimit janë hartuar çdo 60 ditë.

**BASHKIA RROGOZHINË**

Është bërë nonitorimi i UM si dhe i është vendosur në dispozicion Policisë.

**BASHKIA CËRRIK**

Koordinatori Vendor çdo 60 ditë përgatit raportin për Monitorimin e Urdhërit të Mbrojtjes për çdo rast të pajisur me UM. Një kopje të këtij raporti ja dërgon Komisariatit të policisë Cërrik. Ndër sfidat gjatë këtij procesi është mungesa e një Punonjësi Social, pasi Koordinatori Vendor mbulon dhe pozicionin e specialistes së Barazisë Gjinore në të gjithë territorin e bashkisë.

**BASHKIA KUÇOVË**

Është bërë monitorimi i rasteve të urdhrave të mbrojtjes nga koordinatorja lokale, ku është mbajtur proces-verbal për secilin rast të monitoruar. Problem është mungesa e fondeve për të lëvizur, ndaj procesi është kryer nëpërmjet telefonit.

**BASHKIA KLOS**

Monitorimi i UM është realizuar çdo 60 ditë nga ana e koordinatorit vendor, dhe çdo raport i është dërguar policisë në rrugë zyrtare.

**BASHKIA POLICAN**

Për vitin 2021 nuk ka patur raste me UM por me UMM ose kallëzim që ka çuar në arrestimin e të dhunuarit.

**BASHKIA BERAT**

Për çdo UM i cili vjen nga Gjykata e Rrethit, kontaktohet, kryhen vizita në familje, takime ne zyrë dhe KVDHF harton monitorimin e UM. Për 6 raste gjatë vitit 2021 është dërguar monitorimi i UM në Policinë Vendore. Kemi një bashkëpunim të mirë ndër-institucional edhe pse disa herë SPZ gjatë vlerësimit të riskut nuk njoftojnë KVDHF.

**BASHKIA KRUJË**

Është përgatitur sipas protokollit raporti cdo 60 ditë për secilin rast me UM dhe i është dërguar drejtorisë së policisë. Raportohet se nga ana e koordinatorit vendor janë monitoruar rastet, si dhe është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me të mbijetuarat e dhunës.

**BASHKIA URA VAJGURORE**

Për çdo rast dhune me UM është realizuar raporti i monitorimit çdo 60 ditë nga Koordinatori i dhunës dhe rastet janë të hedhur në sistemin REVALB.

**BASHKIA PUKË**

Aktualisht Bashkia Pukë ka në monitorim 1 rast me UM, i cili po trajtohet nga skema e ndihmës ekonomike si dhe po monitorohet rregullisht. Çdo 60 ditë realizohen vizita në terren dhe përgatitet raporti i cili i dërgohet zyrtarisht edhe policisë së shtetit.

**BASHKIA PATOS**

Gjatë vitit 2021 monitorimi i urdhërave të mbrojtjes është realizuar kryesisht nëpërmjet komunikimeve telefonike me të mbijetuarat e dhunës në familje, vizitave në familje si dhe takimeve në ambientet e bashkisë. Monitorimi i UM është realizuar pa hasur problema dhe në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

**BASHKIA FUSHË ARRËZ**

Është përgatitur sipas protokollit raporti cdo 60 ditë për secilin rast me UM dhe i është dërguar drejtorisë së policisë. Raportohet se nga ana e koordinatorit vendor janë monitoruar rastet, si dhe është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me të mbijetuarat e dhunës.

**BASHKIA FIER**

Bshkia Fier raporton se UM-të janë monitoruar nëpërmjet telefonit, kur ka qenë e nevojshme raporti i është dërguar policisë edhe para afatit 60 ditor të parashikuar nga ligji.

**BASHKIA SELENICË**

Koordinatinatori vendor ka qënë në dispozicion dhe gjithmonë e gatshme për të survejuar dhe monitoruar te gjitha rastet me UM, raportohet se për vitin 2021 nuk ka patur raste të thyerjes së urdhërit të mbrojtjes.

**BASHKIA HIMARË**

Në Bashkinë e Himarës ka vetëm një rast monitorimi për UM. Monitorimet nuk janë realizuar çdo 60 ditë pasi palët nuk jetojnë në të njëjtën banesë (njëri në Vlorë dhe pala tjetër në Greqi).

**BASHKIA SARANDË**

Monitorimi është i vështirë për shkak se koordinatori vendor nuk punon me kohë të plotë për rastet e dhunës në familje, por është i ngarkuar edhe me detyra të tjera. Pavarësisht këtij fakti, kur është konstatuar shkelje e UM nga dhunuesi është njoftuar inspektori i zonës dhe e mbijetuara është orientuar drejt policisë.

**BASHKIA VLORË**

Koordinatori ka kryer monitorim dhe raportim të vazhdueshëm çdo 60 ditë, por ka patur raste edhe para këtij afati për shkak të rrezikshmërisë dhe vështirësisë së rastit. Në rastet e thyerjes së Urdhërit të Mbrojtjes menjëhere koordinatori vendor ka vënë në dijeni policinë dhe janë marrë masat për ndërhyrjen në vazhdim të rastit të dhunës. Koordinatori gjithashtu informon të mbijetuarat për të denoncuar nëse konstaton se thyhet UM nga pala e paditur. Një problematikë e hasur ka qenë mungesa e dëshirës e të mbijetuarës për të denoncuar personalisht thyerjen e UM pranë policisë.

**BASHKIA DROPULL**

Nuk raporton asnjë rast me UM.

**BASHKIA MALËSI E MADHE**

Kordinatori vendor gjatë ka qenë në dispozicion të të gjitha rasteve që kanë patur nevojë për ndihmë dhe janë monitoruar rregullisht rastet me UM. Çdo 60 ditë është bërë raportimi i çdo rasti duke ia dërguar policisë së shtetit.

**BASHKIA POGRADEC**

Rastet e monitorimit të Urdhrave të Mbrojtjes janë kryer në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Pogradec dhe Njesisë së Mbrojtjes së fëmijëve në rastet kur edhe fëmijët janë me Urdhër Mbrojtjeje. Gjatë monitorimit është plotësuar raporti i monitorimit dhe është dorëzuar në polici.

**BASHKIA SHIJAK**

Në Bashkinë e Shijakut Koordinatori vendor çdo 60 ditë përgatit raportin e monitorimit të rasteve të UM-së dhe e ndan me Drejtorinë e Policisë. Rastet me UM janë monitoruar edhe kur kanë ndërruar vendbanimin.

**BASHKIA KORÇË**

Bashkia Korcë raporton se koordinatori vendor për çdo viktimë të dhunës ka përgatitur raportin e monitorimit çdo 60 ditë. Gjithashtu nga ana e bashkisë, këtyre viktimave iu është mundësuar dhe ndihma ekonomike. Raporti i monitorimit për çdo viktime të dhunës në familje i është vënë në dispozicion Komisariatit Korçë.

**BASHKIA MALIQ**

Monitorimi i urdhërave të mbrojtjes në Bashkinë Maliq është realizuar në bashkëpunim me Policinë.

**BASHKIA KONISPOL**

Bashkia Konispol raporton vetëm një rast dhune me UM 3 muaj, në lidhje me monitorimin e së cilit është përgatitur dhe dërguar raporti policisë.

**BASHKIA SKRAPAR**

Në Bashkinë e Skraparit monitorimi i urdhërave të mbrojtjes nuk është realizuar, pasi ato janë lëshuar për një afat shumë të shkurtër dhe koordinatori vendor është vënë me vonesë në dijeni, kohë në të cilën urdhërat kishin mbaruar efektin.

**BASHKIA BELSH**

Në Bashkinë Belsh, monitorimi i UM është realizuar nga koordinatorja e cila ka mbajtur procesverbal në lidhje me monitorimin e rastit. Një nga sfidat e procesit të monitorimit është edhe mungesa e logjistikës për të bërë monitorim nga afër ndaj monitorimi është realizuar me telefon.

**BASHKIA KURBIN**

Bashkia Kurbin raporton se në mungesë të koordinatorit vendor, rastet e monitorimit janë realizuar nga Përgjegjësja e Sektorit.

**BASHKIA PEQIN**

Bashkia Peqin raporton se detyrat e koordinatorit janë përmbushur me sukses.

**BASHKIA MIRDITË**

Në Bashkinë e Mirditës, janë monitoruar rastet me UM dhe është raportuar në polici në respekt të parashikimeve ligjore. Janë monitoruar rastet me UM dhe është raportuar në polici me informacion të detajuar.

**BASHKIA ELBASAN**

Koordinatori Vendor ka bërë raportim periodik çdo 60 ditë me konkluzione dhe rekomandime të bazuara në takimet me viktimat.

**BASHKIA GJIROKASTËR**

Koordinatorja Vendore përgatit raportin e monitorimit çdo 60 dtë për çdo rast dhe e paraqet atë në polici.

**BASHKIA LEZHË**

Nga ana e koordinatit vendor është përgatitur raporti i rregullt çdo 60 ditë si dhe është vënë në dijeni Policia e Lezhës.

**BASHKIA KUKËS**

Monitorim i zbatimit të UM është realizuar në bashkëpunim me punonjësit e policisë.

**BASHKIA DIBËR**

Monitorimi i rasteve të UM është monitoruar dhe ka patur bashkëpunim të mirë midis policisë dhe koordinatorit vendor.

**BASHKIA BULQIZË**

Monitorimi i UM është realizuar nga koordinatorja vendore për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, çdo 60 ditë për secilin rast dhe janë publikuar në sistemin e Revalbit.

**BASHKIA KAVAJË**

Bashkia Kavajë raporton se është realizuar raportimi periodik çdo 60 ditë, raporti i cili i është vënë në dispozicion Policisë.

**BASHKIA FINIQ**

Në Bashkinë Finiq janë monitoruar në vazhdimësi 2 rastet e dhunës së raportuar deri në momentin e përfundimit të UM si dhe është raportuar vazhdimisht në polici. Një nga sfidat e hasura është mbajtja në kontroll e situatës, dhe respektimi i UM, për ruajtjen e distancës nga dhunuesi, pasi në një nga rastet, viktima e dhunës jetonte në të njëjtin fshat me dhunuesin.

**BASHKIA KËLCYRË**

Në Bashkinë Këlcyrë rasti i vetëm me UM për vitin 2021 ka qenë i monitoruar vazhdimisht. Një nga sfidat e hasura ka qenë mbajtja në kontroll e situatës, pasi viktima jetonte në të njëjtën banesë me dhunuesin.

**BASHKIA LUSHNJE**

Koordinatori i dhunës në familje ka përgatitur raportet çdo 60 ditë.

**BASHKIA DELVINË**

Bashkia Delvinë raporton se janë monitoruar UM me vizita në familje ose komunikim telefonik. Afati 60 ditor për raportim nuk është respektuar, pavarësisht se raportimi është bërë vazhdimisht. Sfida ka qenë mbajtja në kontroll e situatës, nëpërmjet telefonit, kjo pasi janë konstatuar raste ku të mbijetuarat e dhunës pretendojnë se vizitat tona në familje, ndikojnë negativisht te fëmijët.

**BASHKIA SHKODËR**

Gjatë vitit 2021 raportohet se janë monitoruar 150 raste me UM, ku janë hartuar raporte për secilin rast në bashkëpunim me drejtorinë vendore të policisë së shtetit.

**BASHKIA LIBRAZHD**

Monitorimi i UM për vitin 2021 nga ana e koordinatorit vendor është realizuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet vizitave në familje apo kontaktit të vazhdueshëm telefonik.

**BASHKIA MEMALIAJ**

Raportohet se për vitin 2021 janë monitoruar rastet e dhunës së raportuar deri në momentin e përfundimit të UM. Është bashkëpunuar në vazhdimësi me policinë. Sfida ka qenë kontrolli i situatës, pasi të mbijetuarat e dhunës jetojnë në të njejtën banesë me dhunuesin, me mungesë të fondeve financiare, si edhe me staf social, të pamjaftueshëm për monitorimin e UM-ve.

**BASHKIA PËRMET**

Bashkia Përmet raporton se për vitin 2021 nuk ka patur raste me UM.

**BASHKIA MALLAKASTËR**

Bashkia Mallakastër raporton se janë monitoruar në vazhdimësi në policinë vendore lidhur me 3 rastet e dhunës deri në momentin e përfundimit të UM. Sfida ka qenë mbajtja në kontroll e situatës, pasi në të tre rastet, të mbijetuarat e dhunës jetonin pranë dhunuesit.

**BASHKIA TROPOJË**

Nga Bashkia Tropojë raportohet se Shërbimi Social në Bashki në bashkëpunim me policinë kanë kryer monitorim të vazhdueshëm në banesa përgjatë periudhës së UM-ve.

**BASHKIA TEPELENË**

Janë monitoruar në vazhdimësi, sipas procedures ligjore, në bashkëpunim me policinë e shtetit, rastet e dhunës së raportuar deri në momentin e përfundimit të UM. Sfidë mbetet mbajtja në kontroll e situatës, pasi në të gjitha rastet të mbijetuarat e dhunës jetojnë shumë pranë dhunuesit.

**BASHKIA HAS**

Bashkia Has raporton se monitorimi i Urdhërave te Mbrojtjes është kryer çdo 60 dite nga KVDHF sipas detyrimit ligjor. Rastet dhe raportet e monitorimit të UM janë hedhur në sistemin REVALB, si dhe u janë dërguar kopjet e raporteve të monitorimit të UM punonjësve të policisë. Nuk janë hasur vështirësi ose thyerje të masave të UM gjatë monitorimit.

**BASHKIA DURRËS**

Monitorimi i UM realizohet kryesisht, pavarësisht se hasen vështirësi për shkak të mungesës së mjeteve logjistike dhe burimeve njerëzore.

**BASHKIA MAT**

Monitorimi i UMM dhe UM bëhët nga koordinatori vendor pranë Bashkisë Mat në mënyrë periodike, në përmbushje të parashikimit të ligjit. Sfidat në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor mbetën problemet me logjistikën për shkak të shpërndarjes gjeografike të rasteve.

**BASHKIA GRAMSH**

Monitorimi i urdhëra të mbrojtjes është bërë në mënyrë të rregullt për rastet e pajisura me UM. Bashkëpunimi me policinë vazhdon të jetë i rregullt.

**BASHKIA DEVOLL**

Monitorimi i UM është realizuar çdo 60 ditë, ku është informuar edhe policia. Në lidhje me sfidat theksohet problematikat e infrastrukturës duke vijuar monitorimin nëpërmjet telefonit apo takimeve periodike pranë zyrave të Bashkisë Devoll.

**BASHKIA VORË**

Monitorimi për zbatimin e urdhërave të mbrojtjes është realizuar në mënyrë periodike nga specialist i dhunës në familje në bashkëpunim me policinë. Sfida kryesore është transporti, terreni dhe mungesa e logjistikës.

**BASHKIA KOLONJË**

Nga ana e KVDHF është monitoruar çdo masë e marrë e mbrojtjes për viktimën. Për çdo UM është kryer raporti i monitorimit dhe i është vënë në dispozicion policisë. Nuk janë evidentuar thyerje të masave të marra të mbrojtjes. Monitorimi në banesë është një nga sfidat për shkak të mungesës së mjeteve të transportit.

1. Mungesa e një Koordinatori Vendor, përgjegjës vetëm për detyrat që duhet të kryejë në përputhje me kërkesat e ligjit, sjell mungesë të theksuar të vigjilencës në monitorimin e UM, duke qenë se kjo detyrë mbulohet nga një punonjës tjetër i cili ka dhe detyra paralele.
2. Mungesa e mjeteve të transportit për monitorimin fizik të të mbijetuarave të dhunës të pajisura me urdhër mbrojtje është një sfidë tjetër, e cila duhet domosdoshmërisht të adresohet për një monitorim sa më efiçent. Nga ana tjetër vlen për t'u përmendur praktikat e mira të Bashkisë Rroskovec, Berat, Elbasan, Durrës, Mat, etj të cilës kanë kryer në mënyrë të vazhdueshme vizita për të monitoruar respektimin e UM.
3. Përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike e të mbijetuarave të pajisur me UM në Bashkinë e Korçës dhe Pukës është një praktikë e mirë e cila do të vlente dhe ndihmonte edhe të mbijetuarat e dhunës në bashkitë e tjera.
4. Bashkia Përmet dhe Bashkia Dropull raportojnë se për vitin 2021 nuk kanë patur asnjë rast me UM, ndërkohë që Bashkia Skrapar është e vetmja Bashki që raporton moskryerjen e monitorimit të urdhrave të mbrojtjes.

> *Referuar të dhënave të raportuara nga Bashkitë në lidhje me adresimin e dhunës në familje, bashkëpunimin me shërbimin e provës dhe planin individual të ndërhyrjes janë pasqyruar të dhënat në formë grafike.*

## ADRESIMI I DHUNËS NË FAMILJE DHE MASAT QË KA MARRË EKZEKUTIVI

Në grafikun e mëposhtëm janë pasqyruar masat që ka marrë ekzekutivi në adresimin e shërbimeve si pasojë e ndryshimit të legjislacionit, kufizimeve të masave të jashtëzakonshme si dhe rritjes së kërkesës për shërbime.

### MASAT E MARRA NË BASHKËPUNIM ME ORGANET LIGJZBATUESE, PËR NDARJEN E DHUNUESIT NGA FAMILJA, ME QËLLIM LËNIEN NË PËRDORIM TË BANESËS FAMILJARE VIKTIMËS DHE FËMIJËVE.



## BASHKËPUNIMI ME SHËRBIMIN E PROVËS




## PLANI INDIVIDUAL I NDËRHYRJES




## KOSTOT FINANCIARE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për të mbijetuarat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij", i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Buxheti i shtetit, fondet e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe mbështetja e donatorëve mbeten burimet financiare kryesore për përballimin e pasojave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Më poshtë është paraqitur edhe situata buxhetore për secilën bashki në bazë të raportimeve të kryera sa i takon financimeve nga Bashkitë për adresimin e dhunës në famijle dhe asaj me bazë gjinore për vitin 2021.

## NUK KA BUXHET TË AKORDUAR NGA BASHKIA



Nga analizmi i të dhënave të paraqitura nga ana e Bashkive rezulton që **BASHKIA PUSTEC** e cila nuk ka të parashikuar në buxhetin e saj një fond të posaçëm për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore është mbështetur nga UNDP me një projekt për dhunën në familje fond i cili ka ndikuar edhe në ngritjen e MKR-së, në rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, përmes trajnimeve, menaxhimit të rasteve, takimeve, shkëmbimit të përvojave të bashkive të tjera në aktivitetet e planifikuara, etj. Gjithashtu nëpërmje këtij fondi është bërë e mundur dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit në zonat rurale dhe urbane dhe në komunitetin në shkolla: Janë publikuar aktivitetet e bashkisë në mediat sociale dhe / ose lokale. Si dhe është bërë e mundur rritja e besimit te komunitetit, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës në familje ndaj institucioneve përgjegjëse në nivel lokal. Për shkak të mungesës në buxhet Bashkia e Pustecit ofron vetëm shërbimin "Këshillim ligjor", në rastet e evidentimit të të mbijetuarave të dhunës.

> ***30 Bashki raportojnë se në buxhetin e tyre nuk kanë të parashikuara fonde për ofrimin e shërbimeve në kuadër të trajtimit të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.***

**BASHKIA POLIÇAN,** në kushtet e mungesës së buxhetit ka të punësuar me kohë të pjesshme koordinatorin vendor të dhunës. Kjo bashki raporton se është mbështetur nga UNDP për rastet e trajtimit të dhunës duke qenë se nuk ka një fond të caktuar për të ofruar shërbime në këtë aspekt.

**BASHKIA KRUJË** raporton se nuk ka një buxhet specifik për rastet e dhunës në familje apo ato me bazë gjinore. Një pjesë të shërbimeve që ajo kryen në këtë fushë janë mbuluar nga organizatat e shoqërisë civile ku mund të përmendim edhe takimet ndërgjegjësuese me komunitetin të ndërmarra nga OJF-të që operojnë në këtë qytet.

**BASHKIA KUÇOVË** e cila nuk ka një buxhet të miratuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, të vetmin burim financimi për ndihmesë ekonomike, psikologjike apo strehim të përkohshëm ka organizatat e shoqërisë civile. Ndihma ekonomike dhe psikologjike, si edhe strehime të përkohshme. Fokus grupet raportojnë një situatë aspak të mirë të menaxhimit të rasteve të dhunës kjo edhe për shkak të kufizimit të buxhetit.

**BASHKIA BERAT** raporton se shumë raste të dhunës janë mbështetur nga projekti i financuar nga "Ofrimi i programeve të reintegrimit ekonomik për të paktën 80 të mbijetuara të DHBGJ në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit" financuar nga UN Women, duke ofruar programe mbështetëse në komunitet që përfshijnë mbështetjen për qera banese, plotësim i nevojave bazike nëpërmjet paketave ushqimore, paketa higjeno-sanitare, veshmbathje, shërbime shëndetësore dhe mbështetje me medikamente/konsulta/vizita, konsulence dhe asistence ligjore me avokat, këshillim dhe asistencë psikologjike, ndërmjetësim për formim profesional dhe punësim, orientim dhe ndërmjetësim për shërbime të tjera nga institucionet. Gjithashtu, gjatë vitit Vatra ka organizuar aktivitete publike ndërgjegjësuese me qëllim sensibilizimin dhe informimin e komunitetit për çështjet e trafikimit, dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.

Në **BASHKINË E RROGOZHINËS** gjithashtu nuk ka të parashikuar një fond të posaçëm për dhunën në familje, por të gjitha shërbimet e kryera në këtë kuadër mbulohen me fondin e shërbimeve sociale, në dispozicion të të mbijetuarave. Bashkia e Rrogozhinës ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës (22 në 2020-38 në 2021) ndaj e ka të nevojshëm edhe parashikimin e një buxheti të fokusuar në trajtimin e të mbijetuarave të dhunës.

Në **BASHKINË E FUSHË ARRËZIT** Koordinatori vendor i dhunës në familje është trajtuar nga buxheti i projektit të PNUD-it, i cili ka patur një vlerë totale prej 1.134.608 lekë. Gjithashtu UNDP ka ndihmuar Bashkinë e Fushë Arrëzit në shërbimet e ofruara për shkak të dhunës të familje apo dhunës me bazë gjinore.

**BASHKIA E URËS VAJGURORE** duke qenë se në buxhetin e bashkisë nuk është parashikuar asnjë fond për trajtimin e rasteve të dhunës nga ana e Bashkisë. Organizatat e tjera të shoqërisë civile kanë ofruar në URËN VAJGURORE paketa ushqimore, mobilim dhe elektro shtëpiake).

Në **BASHKINË E PUKËS**, duke qenë se detyra e koordinatorit kryhet nga një punonjës i bashkisë i cili mbulon edhe funksione të tjera, bashkia nuk ka akorduar asnjë fond për rastet e dhunës në familje. Bashkia Pukë raporton se në kryerjen e detyrave të tyre kanë ardhur në ndihmë organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë ndihmuar në trajtimin e rasteve të dhunës nëpërmjet shërbimeve sociale të ofruara si këshillim psikologjik, strehim emergjent në strehëza etj.

**BASHKIA SARANDË** raporton se për vitin 2021 nuk ka patur asnjë kosto shërbimi pasi të gjitha shpenzimet për rastet e trajtuara janë mbuluar nga buxhetet e institucioneve të tjera pjesë e Mekanizmit të Referimit. Një mbështetje evidente Bashkia e Sarandës për trajtimin e rasteve të dhunës e ka marrë edhe nga organizatat e shoqërisë civile të cilat e kanë mbështetur punën e Bashkisë në kuadër të trajtimit të rasteve të dhunës nëpërmjet shërbimeve psiko-sociale, këshillime psikologjike, mbështetje ligjore, në rastet e strehës së emergjencës ofrojnë shërbimin e ushqimit dhe mbështetje të të mbijetuarës me punonjës social. Shpesh herë, organizatat e shoqërisë civile mbështesin familjet e të mbijetuarave të dhunës me paketa ushqimore dhe higjeno sanitare .

**BASHKIA DROPULL** gjatë vitit 2021 ka qënë pjesë e projektit të PNUD Shqipëri i cili ka kontibuar në shumën financiare 908,420 lek përfshirë në këtë shumë dhe pagesën e koordinatores së dhunës. Në Bashkinë e Dropullit nuk ka një buxhet të parashikuar për ofrimin e shërbimeve në rastet e dhunës në familje apo me bazë gjinore, ndaj raportohet se këto shpenzime janë mbuluar nga PNUD.

**BASHKIA MALËSI E MADHE** është një bashki tjetër e cila për çështjet e dhunës është mbështetur nga OJQ-të pasi nuk ka të parashikuar një buxhet të posaçëm për trajtimin e rasteve të dhunës. Gjithashtu **BASHKIA BELSH** nuk ka të parashikuar një fond të posaçëm për trajtimin e rasteve të dhunës por i ka ardhur në ndihmë përgjatë vitit 2021 puna e organizatave të shoqërisë civile kryesisht për këshillim psikologjik, ndjekje të proceseve të divorcit etj.

Në **BASHKINË E PEQINIT** gjithashtu nuk ka një fond për trajtimin e rasteve të dhunës. Rastet e strehimit emergjent janë ndihmuar nga organizatat që veprojnë në Peqin duke lehtësuar sadopak gjendjen e të mbijetuarave të dhunës.

Në **BASHKINË E SHIJAKUT** ku ka të punësuar vetëm një punonjës për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, në ndihmë kanë ardhur organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë ndihmuar të mbijetuarat me paketa ushqimore, akomodim në strehëz, këshillim ligjor psikologjik dhe kurse profesionale.

Në **BASHKINË E DIBRËS** në kushtet kur nuk ka një buxhet për shërbimet e ofruara në rastet e dhunës, kostot financiare janë mbuluar nga organizata që operojnë dhe bashkëpunojnë me Bashkinë Dibër.Viktimat e dhunës janë mbuluar me paketa ushqimore dhe veshmbathje. Bashkia Dibër raporton nevoja emergjente për rritje të buxhetit në kushtet që e ka të pamundur të ofrojë strehim apo ndihmë ekonomike për të mbijetuarat e dhunës.

**BASHKIA E LUSHNJËS** është një bashki tjetër e cila nuk ka të parashikuar buxhet për vitin 2021 për ofrimin e shërbimeve në rastet e dhunës në familje dhe ato me bazë gjinore. Kostot financiare në këto raste janë mbuluar nga buxhetet e organizatave të shoqërisë civile si shërbime emergjence, pagesë qeraje për të mbijetuarat, strehim etj.

Në **BASHKINË E KUKËSIT** nuk ka një buxhet specific të akorduar për të mbijetuarat e dhunës përveç shërbimeve në strehën e emergjencës ku janë punësuar 3 punonjës. Nga ana e organizatave të shoqërisë civile në këtë bashki është dhënë ndihma me strehim apo mbështetje financiare për të mbijetuarat e dhunës.

**BASHKIA E HASIT** edhe pse raporton rritje të rasteve të dhunës, nuk ka parashikuar një buxhet të posaçëm për rastet e dhunës, ato janë mbuluar nga organizatat e ndryshme kryesisht. Shërbimet e ofruara nga organizatat e shoqërisë civile kryesisht me veshmbathje, medikamente, si dhe për strehimin e tyre .

**BASHKIA SKRAPAR** raporton se në mungesë të një buxheti për trajtimin e rasteve të dhunës dhe ofrimin e shërbimeve, për vitin 2021 me mbështetjen e UNDP ka ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit ku edhe në bashkëpunim me Bashkinë Skrapar janë organizuar trajnime me mësues të 2 shkollave 9-vjeçare dhe shkollës së mesme për t'u njohur me rastet të dhunës ai edhe janë shpërndarë fletpalosje.

**BASHKIA E KURBINIT** raporton se për vitin 2021 nuk ka të parashikuar një buxhet të posaçëm për trajtimin e të mbijetuarave të dhunës. Kjo bashki deklaron se nuk ka të emëruar një koordinator përgjegjës për çështjet e dhunës, si dhe në kushtet kur numri i të mbijetuarave nga 2020-2021 ka pësuar rritje (32-47), ka nevojë urgjente për alokimin e një fondi në favor të ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës.

**BASHKIA DURRËS** dhe **BASHKIA MAT** nuk kanë një fond të dedikuar për të mbijetuarat e dhunës në marrëdhëniet familjare, por të mbijetuarat e dhunës janë referuar dhe janë mbështetur nga organizata dhe fondacione të ndryshme me paketa ushqimore, paketa higjenike, veshmbathje, ndihmë juridike etj.

**BASHKIA E VORËS** Kosto financiare, për të mbijetuarat e dhunës në familje është ndihma, që jepet nëpërmjet bashkisë për vlefshmerinë e urdhërit të mbrojtjes, në rastet kur gjykata e vlerëson UM, bashkia e mbështet të mbijetuarat sa kohë zgjat. UM Ndihmëse është ofruar dhe nga organizatat me bonus ushqime apo qera për banesë.

## KANË BUXHET TË AKORDUAR NGA BASHKIA

**22** Bashki kanë të parashikuar në buxhetet e tyre fonde të posaçme për mbështetjen e të mbijetuarave të dhunës. Bashkia Librazhd ka ofruar bonuse qeraje për të mbijetuarat e dhunës ndërkohë që Bashkia Tropojë, Bulqizë, Finiq, etj kanë vendosur në dispozicion një buxhet të caktuar. Pavarësisht kësaj, buxheti i vendosur në dispozicion mbetet i pamjaftueshëm në raport me nevojat që paraqiten për të mbijetuarat e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore. Konkretisht buxhetet e vendosura në dispozicion mund të mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të shërbimeve që Bashkia ka detyrim t'u ofrojë të mbijetuarave.

| | |
|---|---|
| BASHKIA TEPELENË, MEMALIAJ, PËRMET, DELVINË, KËLCYRË DHE FINIQ | KANË DEDIKUAR 6% NGA BUXHETI I BASHKISË, PAKETA FINANCIARE/EKONOMIKE, PËR FAMILJET DHE PERSONAT NË NEVOJË |
| BASHKIA KLOS DHE LEZHË | KANË DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 250.000 LEKË |
| BASHKIA VLORË DHE BULQIZË | KANË DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 300.000 LEKË PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE. |
| BASHKIA TROPOJË DHE HIMARË | KANË DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 500.000 LEKË PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE. |
| BASHKIA LIBRAZHD | ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK ËSHTË OFRUAR BONUSI I QERASË TË BANESAVE SOCIALE PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS. |
| BASHKIA SHKODËR | 2,526 MIJË LEKË PAGA PËR STAFIN, 486 MIJË KOSTO OPERATIVE, 200 MIJË ZBATIMI I SISTEMIT TË REFERIMIT TË RASTEVE PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE. 200 MIJË LEKË ZBATIMI I KARTËS EUROPIANE PËR BARAZI GJINORE 150 MIJË DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS 8 MARSI. |
| BASHKIA TIRANË | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 0,2% TË BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM PËR ADRESIMIN E DHF. |
| BASHKIA CËRRIK | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 633.000 LEKË PËR KATEGORINË E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS NË FAMILJE. |
| BASHKIA SELENICË | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 108.000 LEKË PËR KATEGORINË E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS NË FAMILJE. |
| BASHKIA PATOS | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 118.000 LEKË PËR KATEGORINË E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS NË FAMILJE. |
| BASHKIA POGRADEC | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 571.920 LEKË |
| BASHKIA MALIQ | KA DEDIKUAR NJË BUXHET PREJ 9.000 LEKË |

## KANË BUXHET TË AKORDUAR NGA BASHKIA

**8** Bashki paraqesin një situatë ndryshe të buxhetit, duke raportuar që të mbijetuarat e dhunës mbështeten edhe nga buxheti i Bashkisë po ashtu edhe nga OJF të ndryshme ose projekte të zbatuara në bashkëpunim me pushtetin qëndror.

| BASHKIA GJIROKASTËR | BASHKIA ELBASAN | BASHKIA MIRDITË | BASHKIA FIER |
|---|---|---|---|
| Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër mbështetsin financiarisht Qendrën. Projekti zgjat 3 vite dhe në vitin e dytë 60% e mbështetjes financiare mbulohet nga Ministria dhe 40% nga Bashkia Gjirokastër. Kosto totale e 3 viteve është respektivisht; Ministria 12.507.552 lekë dhe Bashkia 9.076.068 lekë. | Bashkia mbulon me buxhet stafin që angazhohet për çështjet e dhunës në familje dhe bashkëpunon me OJF lokale. | Për vitin 2022 masa e fondit për ofrimin e shërbimeve është 3.648.000 lekë, ndërkohë aktivitete të tjera janë realizuar në bashkëpunim me OJF. | Donacione nga OJF-të, ndihmat emergjente janë ofruar me së shumti nga vetë OJF-të, bizneset, pushteti qendror dhe një pjesë nga bashkia. Të mbijetuarat e dhunës në familje janë asistuar jo vetëm një herë, por disa herë me paketa emergjence. |

| BASHKIA KAVAJË | BASHKIA KORÇË | BASHKIA KOLONJË | BASHKIA KONISPOL |
|---|---|---|---|
| Kostot financiare janë përballuar në bashkëpunim me OJF. | 136.900 lekë Strehëzë emergjente për të mbijetuarat e dhunës në familje<br>252.000 lekë Total<br>388.900 lekë<br>Nevojat e të mbijetuarave të dhunës në familje plotësohen duke bashkëpunuar me organizatat. | Në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje Bashkia Kolonjë është mbështetur nga UNDP me fond 901.500 lek.<br>Kostoja financiare për vitin 2021 ka qënë në shumën prej 770.435 lek. | Bashkia në bashkëpunim me UNDP e kanë pasur masën e fondit 923.250 lekë për periudhën e raportimit, ku gjatë këssaj periudhe u vendos dhe koordinatori vendor për dhunën në familje si një pozicion i veçantë në strukturën e Bashkisë. |

Në një këndvështrim të përgjithshëm, rezulton se numri i lartë i Bashkive të cilat nuk kanë akorduar asnjë fond për ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës, ka sjellë edhe shërbime më të dobëta më larg komunitetit si dhe më shumë vështirësi për punën e stafit të punësuar në Shërbimin Social në mungesë të buxhetit. Praktika të mira rezultojnë përpjekjet e Bashkisë së Korçës e cila përvec vëmendjes që i ka ofruar të mbijetuarave të dhunës, duke ofruar të gjitha shërbimet për ndihmesën e tyre, akaordimin e një fondi prej 136.900 për strehëzat emergjente dhe 252.000 lekë për viktimat e dhunës në familje në vitin 2021 ka firmosur një Marrëveshje Bashkëpunimi me organizaten "Tjetër Vision". Nëpërmjet kësaj marrëveshje janë ndihmuar 20 gra viktima të dhunës në familje. Ndihma konsiston në grante, paketa ushqimore, pagesë qiraje, paketa higjeno-sanitare, shërbim psikologjik, kite shkollore etj.

Ndihma ushqimore si dhe paketa higjeno-sanitare janë ofruar edhe nga organizata "Mëshirë pa kufi për Shqipërinë" ,"UNICEF", etj.

Ndërkohë bashki të tjera janë në nevojë emergjente për buxhetimin e shërbimeve në kuadër të dhunës në familje, strehimin dhe ndihmesën e të mbijetuarave të dhunës për përmirësimin dhe reintegrimin e tyre.

# KAPITULLI 3

## 3.1. PRAKTIKAT E MIRA TË MENAXHIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS PËR VITIN 2021

### BASHKIA SHIJAK

Është arritur bashkëpunim me strehëzën e emergjencës dhe si rezultat janë strehuar disa të mbijetuara të dhunës.

### BASHKIA KLOS

Të gjitha rastet e pajisura me UM kanë marrë zgjidhje.

### BASHKIA PEQIN

Është marrë në mbrojtje një e mbijetuar dhune, sipas vlerësimit përkatës, është pajisur me um dhe rasti është monitoruar deri në dhënien e kujdesit të fëmijëve.

### BASHKIA DIVJAKË

Gratë të mbijetuara të dhunës me ndihmën e bashkisë dhe OJQ-ve me të cilat bashkia operon kanë hapur aktivitete/biznese të vogla duke vazhduar jetën.

### BASHKIA RROGOZHINË

Punësim i të mbijetuarave të dhunës dhe ndihmesë financiare. janë ndihmuar financiarisht dhe punësuar të mbijetuarat e dhunës në familje si edhe të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

### BASHKIA FUSHË ARRËZ

Janë gjetur mundësi punësimi për të mbijetuarat e dhunës si dhe mundësi shkollimi për fëmijët përveç asistimit dhe monitorimit të rastit.

### BASHKIA CËRRIK

1. Bashkëpunimi me shoqatën "Forumi i Gruas Elbasan" Qendra "Vatra" Vlorë dhe Sektori Social koordinuan punën për të mbështetur të mbijetuarën e dhunës me banesë me qira dhe largimin në një ambient të sigurt larg dhunuesit.
2. Një praktikë e mirë që u ndoq gjatë vitit 2021 ishte ofrimi i shërbimeve në cdo shtëpi nga grupet e patronazhimit si dhe vënia në dispozicion e numrave të kontaktit të bashkisë për referimin e çdo problematike të shfaqur nga qytetarët.

### BASHKIA KËLCYRË

1. Në bashkëpunim me Komisariatin Këlcyrë, është evidentuar në kohë rasti i dhunimit, është ndaluar dhe janë marrë masat për të suportuar të dhunuarën, nga Bashkia.
2. Bashkëpunimi me OJF Linja e Këshillimit për gra dhe vajza, e cila ndaloi aktivitetin për vitin 2022.

### BASHKIA KONISPOL

Pas ndihmës së dhënë nga bashkia e mbijetuara e dhunës sëbashku me dy fëmijët e mitur u sistemua në një qytet tjetër. shpenzimet u mbuluan nga OJQ me të cilën bashkia ka bashkëpunim.

### BASHKIA KUKËS

Është ofruar mbështetje për 3 raste dhune në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në Kukës.

### BASHKIA MIRDITË

Punë e vazhdueshme për ndërgjegjësimin e popullatës, falë së cilës është ritur dhe numri i denoncimeve.

### BASHKIA LUSHNJE

Hartimi i formularit të nevojave të të mbijetuarës.

## BASHKIA DELVINË

Në bashkëpunim me UNDP janë realizuar trajnime, për menaxhimin,, koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve për të identifikuar, referuar dhe për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës në familje në kohë dhe me efiçencë. Bashkëpunim me shoqatën Jona në Sarandë.

## BASHKIA BERAT

Në shtator të vitit 2021 është ngritur Strehëza e emergjencave 72 orëshe për VDH ku në total janë strehuar dhe ofruar shërbime mbështetëse për 6 raste.
Raste suksesi të gra/vajza VDHMF kemi 6 raste, të cilat janë ndërmjetësuar për punësim dhe vazhdojnë punojnë rregullisht në biznese private, janë fuqizuar ekonomikisht me mbështetjen e vazhdueshme nga shërbimi social.

## BASHKIA PUKË

Janë dërguar në strehëzën Shkodër disa të mbijetuara dhune të mbështetura dhe orientuara nga bashkia e Pukës.

## BASHKIA MALËSI E MADHE

Nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm me policinë e shtetit janë shmangur disa raste të dhunës ekstreme.

## BASHKIA SARANDË

Mbështetje dhe punësim i të mbijetuarave të dhunës.

## BASHKIA DROPULL

Edhe pse nuk ka patur raste dhune për vitin 2021 si praktikë e mirë evidentohet ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i popullatës.

## BASHKIA BELSH

Janë menaxhuar rastet e dhunës në mënyrë efektive si dhe evidentohen raste të punësimit në fasoneri për të mbijetuarat e dhunës në bashkinë Belsh.

## BASHKIA POGRADEC

Reintegrimi i të mbijetuarave të dhunës në familje. Këshilli i Bashkisë Pogradec në dhjetor të vitit 2021 ka miratuar edhe Planin e reintegrimit për të mbijetuarat e dhunës ne familje.

## BASHKIA SHKODËR

- Krijimi i Strehëzës për trajtimin e rasteve emergjente.
- Krijimi i 12 qendrave Komunitare për Familjen 7 nga të cilat janë në zona urbane dhe 5 në Njësitë Administrative.
- Dëgjesa publike në Njësitë Administrative me gra edhe vajza.

## BASHKIA VLORË

- Ofruar ndihmë ekonomike për të mbijetuarat.
- Janë ofruar banesa me qera me mbështetjen e organizatave.
- Bashkia ka punuar për reintegrimin e të mbijetuarave.
- Fëmijët e të mbijetuarave të dhunës iu është mundësuar kopshti dhe çerdhja falas.
- Ky është viti i 6 që fëmijët e të mbijetuarave të dhunës frekuentojnë kopshtin dhe çerdhen falas.

## BASHKIA LIBRAZHD

Raste suksesi në bashkinë librazhd janë rastet ku të mbijetuarave të dhunës ju është mundësuar punë dhe banesë.

## BASHKIA SELENICË

Të mbijetuarës së dhunës i është ofruar ndihmë ekonomike, ligjore dhe një banesë me qera me mbështetjen e organizatave. E mbijetuara ka filluar të reintegrohet në jetën e përditshme.

## BASHKIA LEZHË

Ndërhyrje në kohë të stafit të bashkisë kanë parandaluar raste të cilat mund të përfundonin fatale.

## BASHKIA TIRANË

156 raste nga 752 janë asistuar dhe trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me një paketë të plotë shërbimesh nga Koordinatorja Vendore në Bashkinë Tiranë.
Përmes bashkëpunimit me organizatën "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" është mundësuar që fëmijët e të mbijetuarave të dhunës në familje të përfitojnë gjatë viteve objekt monitorimi nga mbështetja në Kopshtin në Shkozë nëpërmjet mësuesëve, mësuesëse ndihmës, etj. Organizatës i është dhënë në dispozicion ambjenti si dhe mbulohen shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit.
Fondi për Fuqizimin e Grave dhe Nxitjen e Sipërmarrjes I, II dhe III, i alokuar për herë të parë në vitin 2016, në shumën totale 6,000,000 Lek, nga i cili kanë përfituar 16 gra me ide të suksesshme biznesi, nëpërmjet granteve te financimit nga 280,000 - 420,000 Lek, për secilin plan-biznesi të zhvilluar me sukses dhe të realizueshëm, nga i cili janë mbështetur kryesisht gratë kryefamiljare.
Bashkia Tiranë ka krijuar një praktikë të mirë me analizat e nevojave të grupeve të ndryshme përfshirë të mbijetuarat e dhunës në marrëdhëniet familjare, aktivitet të organizuar dhe për çdo iniciativë të ndërmarrë.
• Fushata ndërgjegjësuese dhe informuese në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore.

## BASHKIA KOLONJË

Në ndërhyrje të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare janë marrë masat e duhura të mbrojtjes duke përfshirë sigurinë e jetës së të mbijetuarës. Ju është ofruar paketa e shërbimeve mbështetëse si, shërbim ligjor falas, këshillim psikologjik, pako ushqimore, ndihmë ekonomike, bonus strehimi, gjithashtu ju është ofruar edhe punësim nga programet e zyrës së punësimit.

## BASHKIA VORË

Adresimi i dhunës në familje në një rast si dhe monitorimi dhe menaxhimi i situatës ku është bërë e mundur largimi i dhunuesit nga banesa, mundësimi i bonusit të qerasë për të mbijetuarën në bashkëpunim me shoqatat.

## BASHKIA KORÇË

Diskutim në tryeza të përbashkëta mbi rastet e dhunës në familje.
Vendosja në dispozicion e numrit të telefonit falas si dhe realizimi i fushtave ndërgjegjësuese.
Përpilimi i statistikave si dhe regjistrimii rasteve të dhunës në sistemet online.
Vizita në familjet e të mbijetuarave të dhunës.
Ndarja e pozicionit të koordinatores së dhunës në familje me specialisten e barazisë gjinore.
Rast suskesi për vitin 2021 është largimi i një dhunuesi nga banesa në një familje ku një nënë dhunohej vazhdimisht në Njësinë Administrative Bulgarec.
Nënës i është lidhur ndihmë ekonomike 9000 lekë në muaj si dhe i është mundësuar një kurs për rrobaqepëse.
Zonja sot punon si rrobaqepëse e pavarur në biznesin e saj.

## BASHKIA FIER

Disa raste suksesi të referuara nga bashkia Fier dhe të mbështetura nga qendra për nisma ligjore qytetare zhvillimi i sesioneve informuese.

## BASHKIA KAVAJË

Disa raste suksesi të referuara nga bashkia Fier dhe të mbështetura nga qendra për nisma ligjore qytetare zhvillimi i sesioneve informuese.

## BASHKIA GRAMSH

Bashkia ka mbështetur rastet e të mbijetuarave të dhunës në familje duke plotësuar nevojat e tyre në masë të konsiderueshme. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme VDHF kanë marrë shërbime të cilat janë mbyllur me sukses në varësi të ploblematikës që ka pasur secili rast.

## BASHKIA URA VAJGURORE

Dy të mbijetuara të dhunës janë mbështetur maksimalisht nga koordinatorja e dhunës si dhe projektet e OJF-ve.

## BASHKIA FINIQ

1. Mundësuar punësim një të mbijetuare dhune.
2. Mundësuar punësim dhunuesit të një të mbijetuare dhune pas kryerjes së dënimit dhe trajtim kunër konsumimit të alkoolit kjo mundësoi dhe ribashkimin e tyre.
3. Bashkëpunim me shoqatën "Jona"në Sarandë dhe "Shën Kozma" me qendër në Livadhja.

## BASHKIA TROPOJË

Është punësuar në Bashkinë e Tropojës, Sektori i Pastrim Gjelbërimit një e mbijetuar e dhunës. Pas ndërmjetësimit nga punonjësi social i Bashkisë. Familja mbështetet vazhdimisht me ndihmë ushqimore, veshmbathje dhe material higjeno sanitare.

## BASHKIA MEMALIAJ

Në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Memaliaj, 2 fëmijëve të dhunuar nga prindërit ju është hequr prindërimi dhe nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të autoriteteve bashkiake, të shërbimit social, janë dërguar në shtëpinë e kujdesit fëminor, Sarandë.
Bashkëpunim me kryepleqësitë e fshatrave të Bashkisë Memaliaj.
Praktika të mira janë edhe bashkëpunime me shoqata në Gjirokastër për paketa ushqimore.

## BASHKIA DIBËR

Krijimi dhe funksionimi i qëndrës së emergjencës në bashkëpunim me znj. Argita Vido e cila është në ndihmë të grave të dhunuara për t'i sistemuar përkohësisht.

## BASHKIA DURRËS

Bashkëpunim shumë i mirë i Bashkisë Durrës me institucionet përgjgjëse për trajtimin dhe monitorimin e viktimave të dhunës.

## BASHKIA HAS

Asistimi nga ana e bashkisë për një të mbijetuar dhune (nënën me fëmijë) në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Me mbështetjen e avokates së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, familja u pajis me Urdhër Mbrojtje ndërkohë që përfitonte shërbimet në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.
Nëna nisi punë dhe regjistroi fëmijët në kopësht dhe çerdhe duke filluar të reintegrohet.

## BASHKIA GJIROKASTËR

Punë e vazhdueshme me të mbijetuarën dhe dhunuesin në një rast në të cilin kemi mundësuar edhe uljen e mosmarrëveshjeve.

## BASHKIA DEVOLL

Ndër rastet e suksesit përmëndet asistimi në spitalin e Bilishtit nga ana e sektorit të kujdesit social, rasti i abuzimit seksual të një gruaje 43 vjecare e kartelizuar, pranë shëndetit mendor me prapambetje mendore të moderuar. Nga ekzaminimet rezultoi një shtatzani 26 javëshe. Rasti u referua në komisariatin e policisë Devoll. Duke mbajtur parasysh faktin se në Shqipëri mungojnë qendrat për personat me aftësi të kufizuara, pasi kriter është mosha, në bashkëpunim me kishën françeskane dhe nëpërmjet kontakteve, të drejtpërdrejtë me qendrën "motrat missionare të dashurisë" Durrës, arritëm të strehonim për një periudhë 9 mujore, në këtë qendër, atje ku rasti mori të gjitha shërbimet e nevojshme.

## REKOMANDIME DHE SUGJERIME TË DREJTORIVE TË SHËRBIMIT SOCIAL DHE OJF TË LOKALIZUARA NË 61 BASHKI DREJTUAR KOMISIONIT TË BARAZISË GJINORE DHE PËRFSHIRJES SOCIALE, KËSHILLIT BASHKIAK DHE ALEANCËS SË ZGJERUAR TË GRAVE KËSHILLTARE BASHKIAKE

### 1. BASHKIA TEPELENË

| | DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL | OJF |
|---|---|---|
| Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, Këshilli Bashkiak & Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare Bashkiake | 1.Parashikim në buxhet për punësimin e një Koordinatori Vendor me kohë të plotë, psikolog dhe punonjës social në administratën e Bashkisë si dhe në Njësinë.<br>2.Buxhet i dedikuar për shërbime specifike dhe programe mbështetëse, për rastet e dhunuara.<br>3.Buxhet i dedikuar për menaxhimin e rasteve të dhunës.<br>4.Organizimi i aktivitetetеve ndërgjegjësuese të fokusuara tek edukimi, specifikisht i rinisë & grupeve të margjinalizuara, për të drejtat e njeriut, grave e fëmijëve. | |

### 2. BASHKIA TROPOJË

| | DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL | OJF |
|---|---|---|
| Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, Këshilli Bashkiak & Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare Bashkiake | 1.Miratimin dhe Buxhetimin e një Plani Social për periudhën në vazhdim, për hartimin e së cilit do të duhet ndihma e Shërbimit Social Shtetëror.<br>2.Parashikimi në organikë i burimeve njerëzore shtesë të specializuara për Sektorin e Shërbimeve Sociale, përfshirë edhe Koordinatorin e Dhunës.<br>3.Marrja e masave për ndërtimin dhe mirëfunksionimin e një Qendre Sociale Multidimensionale duke patur parasysh që nuk funksionon asnjë qendër sociale.<br>4.Rritja e fondeve për shërbimet sociale në Bashkinë Tropojë. | Adresimi në mënyrë të shpejtë dhe efikase i çështjeve të ngritura me siper. |

### 3. BASHKIA HAS

| | DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL | OJF |
|---|---|---|
| Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, Këshilli Bashkiak & Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare Bashkiake | 1.Nevoja për programe mbështetëse, hapja e një strehëze ose qendre multifunksionale me disa shërbime baze për rastet e dhunës në familje dhe fëmijet e tyre.<br>2. Rritjen e numrit të shërbimeve për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.<br>3. Përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional për menaxhim të rasteve të dhunës. | Rritja e buxhetit për problematikat me të cilat përballet Bashkia e Hasit përsa i takon rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. |

